



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 351 Akti

Nr. 344 Vendimi  
Tiranë, më 11.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 9.2.2021, ora 14:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Marinela Osmani (Nuni)**, me detyrë Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor (e komanduar).

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, me detyrë Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor (e komanduar), referuar nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë/Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 12.11.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Etleda Çiftja, dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Menjëherë, me hedhjen e shorti komisionerët Firdes Shuli dhe Roland Ilia dhanë dorëheqjen bazuar në vendimin nr. 6, datë 21.1.2019, të Komisionit sipas të cilit, çështjet e subjekteve të rivlerësimit që kanë lidhje familjare midis tyre do të shqyrtohen nga trupa gjykues tërësisht të ndryshëm. Me pranimin e dorëheqjeve të komisionerëve, komisionerja Firdes Shuli me cilësinë e relatores së çështjes u zëvendësua nga komisionerja Alma Faskaj, anëtar zëvendësues i trupi gjykues në shortin fillestar, ndërsa me vendimin nr. 90, datë 4.12.2019, u caktua me short anëtar i trupi gjykues komisioner Suela Zhegu, si zëvendësuese e komisionerit Roland Ilia. Më tej, me vendimin nr. 24, datë 10.4.2020, të Komisionit me rishpërndarjen e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, u caktua me short relator i çështjes komisionerja Brunilda Bekteshi. Ky zëvendësim i anëtarit të trupit gjykues i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, nëpërmjet postës elektronike, e cila pasi është njohur me këtë ndryshim në datë 24.04.2020, po ashtu ka deklaruar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarën zëvendësuese, sikurse edhe me anëtarët e tjerë të trupit gjykues.
4. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 21.11.2019, ka vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftjam, gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues kishin deklaruar se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani.
5. Me vendim të ndërmjetëm, datë 29.5.2020, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar vendimit nr. 3, datë 8.1.2020, të Komisionit, vendosi të administrojë dokumentacion (fotokopje të njehsuara me origjinalin) nga dosja e rivlerësimit për bashkëshortin e subjektit.
6. Në datën 18.12.2020, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, për një kriter të rivlerësimit, konkretisht, vlerësimin e pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 22.12.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe për të sjellë prova për të provuar të kundërtën brenda 10 (dhjetë) ditëve.

**8.** Në datën 28.12.2020, subjekti, parashtroi kërkesën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, si dhe vënien në dispozicion të kopjes së analizës më të detajuar financiare, paraqitur në rezultatet e hetimit për subjektin e saj. Po në këtë datë, mbi kërkimet e subjektit, Komisioni bëri me dije se: (a) lidhur me kërkesën për t'u pajisur me një kopje të dosjes, subjekti mund të paraqitej pranë ambienteve të Komisionit në çdo ditë pune, brenda orarit zyrtar; (b) për vënien në dispozicion të kopjes së analizës më të detajuar financiare, Komisioni e informoi se bashkëlidhur rezultateve të hetimit gjendej Aneksin nr. 1, për metodologjinë e përdorur, si dhe tabelën e detajuar për periudhën 2003 – 2017, sikurse e qartësoi se nëse prej saj do të kishte një kërkesë të mirëfilltë specifike për paqartësi në analizën financiare, mund ta bënte prezent.

**9.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 5.1.2021, brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni, depozitoi parashtrimet, duke depozituar edhe prova shkresore, si dhe në përmbajtje të parashtrimeve kishte paraqitur kërkimin e saj për riçelje të hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, përkatësisht, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**10.** Në datën 8.1.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi: (i) mbi kërkesën e saj për riçelje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, të kontrollit së figurës dhe të aftësive profesionale, kërkesë e cila do të vlerësohej pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar, si dhe do të vlerësoheshin të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna para dhe gjatë seancës. Nëse do të rezultonte se ishin bindëse dhe të mjaftueshme për rihapjen e hetimit, atëherë trupi gjykues do të procedonte me marrjen e vendimit për rihapjen e hetimit edhe për të dy kriteret e tjera; (ii) administrimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur prej saj; (iii) si dhe seanca dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, do të zhvillohej në datën 15.1.2021, në orën 13:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

**11.** Në datë 14.1.2021, përmes postës elektronike, subjekti depozitoi një përmbledhje të qëndrimit të saj ndaj rezultateve të hetimit administrativ, si dhe kërkesën procedurale në lidhje me vijimësinë e këtij hetimi.

**12.** Në datën 15.1.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, vendosi riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, duke e njoftuar këtë vendim në seancën publike të datës 15.1.2021.

**13.** Në datën 25.1.2021, Komisioni, me vendimin nr. 5, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ pas riçeljes edhe për të dy kriteret e tjera, kontrollin figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) mbi paraqitjen e pretendimeve brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

**14.** Në zbatim të vendimit të sipërcituar, në datën 27.1.2021, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit shtesë dhe në datën 4.2.2021, subjekti dërgoi prapësimet në mënyrë elektronike dhe zyrtare së bashku me dokumentacionin shoqëruar mbështetës.

**15.** Në datën 5.2.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 6, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 9.2.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 9.2.2021, për të rifilluar në datën 11.2.2021, për shpalljen e vendimit.

## III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Marinela Osmani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe kreun IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja, është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese<sup>1</sup> dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

#### A/1Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. ILDKPKI-ja, me raportin nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, e cila është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2004, me nr\*\*\* indeksi, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të

---

<sup>1</sup>Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2004 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë e në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**21.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e/të administruara në dosjen e bashkëshortit të saj, si dhe nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaramet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (dh) argumentimet e dhëna me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

➤ **Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 25.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:**

**1. Pasuria “apartament”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> dhe 12 m<sup>2</sup>, ambiente të përbashkëta nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë: “K. P.”, rruga “\*\*\*\*”, ish- S., Kompleksi “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, k. \*\*\*, fituar në bazë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 13.1.2017. Vlera: 82.000 euro. Pjesa takuese: 50%.**

Shpenzime të arredimit të pasurisë nr. \*\*\* (si më lart cituar), në vlerën 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit të shpenzimeve të arredimit janë kursimet e subjektit dhe bashkëshortit nga paga dhe shpërblime të tjera. Burimi i pagesës së shumës 82.000 euro është llogaria bankare në euro me numër \*\*\*, e hapur në “Credins Bank”, e cila është krijuar nga: (i) shitja e pasurisë nr.\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*; si dhe (ii) derdhja në shumën 2.000 euro, në datën 13.1.2017, si vijon.

Burimi i krijimit të shumës prej 82.000 euro, në llogarinë si më lart, janë:

➤ Shitja e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “K.P.”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, e llojit apartament 1+1, me sip. 72 m<sup>2</sup>, me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, në vlerën 80.000 euro (fituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.9.2016, porositur me aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 2.2.2009, me vlerë 67.680 euro, nga e cila është paguar vetëm 63.680 euro). Diferenca prej 4.000 euro (67.680 euro - 63.680 euro) është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonës të pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* (deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 27.10.2016).

➤ Burimi i pagesës së vlerës prej 63.680 euro, si çmim i porositjes së pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, janë të ardhurat nga paga ndër vite dhe shpërblime të tjera të subjektit dhe bashkëshortit, një hua e shlyer tërësisht dhurimi nga prindërit e në shumën 1.500.000 lekë (me motiv pas martesës për shkak të kontributit të subjektit në familje dhe porositjes së një apartamenti banimi).

- Me aplikimin nr. \*\*\*, datë 13.10.2016, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 80.000 euro ose 11.200.000 lekë.
- Shuma 2.000 euro, e derdhur në llogari në datën 13.1.2017, me burim nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit ndër vite.

### **Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ**

**1.1** Kjo pasuri është krijuar në janar të vitit 2017 dhe, për pasojë, rezulton se subjekti e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* dhe më pas në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017. Në këtë të fundit, subjekti e deklaroi me përshkrimin: “*pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> dhe 12 m<sup>2</sup> ambiente të përbashkëta me adresë: “K. P.”, rruga “\*\*\*\*”, ish-S., Kompleksi “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, kati i \*\*\* i banimit, fituar në bazë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 13.1.2017. Vlera: 82.000 euro. Pjesa takuese: 50%*”.

**1.2** Burimi i blerjes së pasurisë është deklaruar llogaria bankare në euro me numër \*\*\*, në “Credins Bank”. Vlera: 80.000 euro (e cila është krijuar për procedurat e transaksioneve noteriale të shitjes së pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me gjendje viti 2016 në shumën 2.000 euro, nga derdhja *cash*, në këtë llogari në datën 13.01.2017, të shumës 2.100 euro, nga kursimet në vite). Subjekti, në mbështetje të deklaramit, ka depozituar<sup>2</sup> dokumentacionin përkatës.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.3** Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet publike rezultoi:

**1.3.i** ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug<sup>3</sup> konfirmon se në emër të shtetasve M. K. O. dhe G.A. O. figuron e regjistruar pasuria me sip. 96 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Vlera: 11.110.000 lekë.

**1.3.ii** OSHEE-ja<sup>4</sup> ka konfirmuar ekzistencën e kontratës së furnizimit Nr. \*\*\*, në instancën e Tiranës.

**1.3.iii** UKT-ja<sup>5</sup> nuk ka konfirmuar ekzistencën e ndonjë kontrate të regjistruar në sistem në emër të subjektit apo bashkëshortit, por subjekti në përgjigje të pyetësorit<sup>6</sup> ka deklaruar se banesa është e lidhur me rrjetin përkatës, kontrata mban numrin \*\*\* dhe se për arsye neglizhence nuk kanë librezë por pagesat i kanë kryer rregullisht.

**1.4** Komisioni hetoi në lidhje me secilin nga burimet e krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të subjektit.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament me sipërfaqe banimi 65 m<sup>2</sup> me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, në vlerën 80.000 euro.

**1.4.i** Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 me përshkrimin “*apartament banimi me sip. 72 m<sup>2</sup>, porositur me aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 2.2.2009, në shumën 67.680 euro, nga të cilat në vitin 2009 është paguar shuma 47.680 euro, për shkak të shtyrjes së punimeve*”. Burimi i pagesës deri në datën 31.12.2009 janë: (i) të gjitha kursimet *cash* në vite (së bashku me bashkëshortin); (ii) një pjesë e huas në shumën 20.000 euro; (iii) të gjitha të ardhurat nga dhurimi në shumën 1.500.000 lekë.

**1.4.ii** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti deklaroi: “*Në zbatim të aktmarrëveshjes nr. \*\*\* rep, datë 2.2.2009, për blerjen e apartamentit, për vitin 2010 është*

<sup>2</sup> Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020 dhe dokumentacioni mbështetës i kësaj shkrese.

<sup>4</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2020.

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020.

<sup>6</sup> Dërguar me tekst të e-mail, datë 20.10.2020.

shlyer detyrimi në shumën 12.000 euro, nga të cilat janë paguar për vitin 2009, 47.680 euro dhe kanë mbetur pa shlyer dhe 8.000 euro për shkak të shlyerjes së punimeve në përfundimin e ndërtimit.”

**1.4.ii.a** Burimi i pagesës deri në datën 31.12.2010 është një pjesë e huas dhe kursimi në shumën prej 500 euro.

**1.4.iii** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti deklaron: “Në zbatim të aktmarrëveshjes nr. \*\*\* rep, datë 2.2.2009, për blerjen e apartamentit, për vitin 2011 është shlyer detyrimi prej 4.000 euro dhe kanë mbetur pa shlyer dhe 4.000 euro për shkak të mosregjistrimit në ZVRPP”. Burimi i pagesës deri në datën 31.12.2011 është pjesa e mbetur e huas dhe nga kursimet.

**1.4.iv** Në deklaratat periodike vjetore 2012 – 2015, subjekti deklaron se ka mbetur pa shlyer shuma prej 4.000 euro, për shkak të procedurave të regjistrimit në ZVRPP dhe të lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes.

**1.4.v** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti deklaron: “Lidhja e kontratës përfundimtare të blerjes së pasurisë nr.\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë: rruga “K.P.”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, e llojit apartament 1+1, me sipërfaqe prej 72 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, datë 17.9.2016, porositur me aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 2.2.2009, me vlerë 67.680 euro, nga e cila është paguar vetëm 63.680 euro. Diferenca prej 4.000 euro është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonesë të pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, (deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 27.10.2016). Me aplikimin nr. \*\*\*, datë 13.10.2016, në ZVRPP-së është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 80.000 euro ose 11.200.000 lekë.

Shitja e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë: rruga “K. P.”, h. \*\*\*, ap.\*\*\*, e llojit apartament 1+1, me sipërfaqe prej 72 m<sup>2</sup>, me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, në vlerën 80.000 euro (fituar me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 17.9.2016, porositur me aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 2.2.2009, me vlerë 67.680 euro, nga e cila është paguar vetëm 63.680 euro).

**1.5** ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug<sup>7</sup> ka informuar dhe depozituar dokumentacion mbi këtë pasuri për të cilën janë kryer edhe transaksione.

**1.6** Trupi gjykues, në analizë të kontratës së shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, rezulton komfor legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, duke u regjistruar në hipotekë në favor të blerësit, arrin në konkluzion se:

**1.7** Subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi marrëdhënien kontraktore të shitjes së pasurisë, nga e cila është përfituar shuma prej 80.000 euro, e përdorur si burim i krijimit të kësaj pasurie.

**A/1 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament, me sip. 65 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “K. P.”, Tiranë.**

**1.8** Subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, por edhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri:

- të gjitha kursimet *cash* ndër vite (së bashku me bashkëshortin);
- një pjesë të huas në shumën 20.000 euro;
- të gjitha të ardhurat nga dhurimi në shumën 1.500.000 lekë.

<sup>7</sup> Shkresë Nr. \*\*\*prot., datë 11.02.2020 dhe dokumentacioni mbështetës i kësaj shkrese.

**1.9** Meqenëse të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie (blerë nga subjekti dhe bashkëshorti), përbëjnë burimin kryesor të krijimit të pasurisë së deklaruar në deklaratën *Vetting*, apartament me sip. 96 m<sup>2</sup>, Komisioni hetoi mbi ligjshmërinë e secilit burim, si dhe mundësinë financiare të subjektit për të investuar në blerjen e këtij apartamenti.

a) Në lidhje me burimin e deklaruar, të ardhura nga të gjitha kursimet cash ndër vite (së bashku me bashkëshortin)

**1.10** Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti<sup>8</sup> kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe të ardhurat e tyre konfirmohen nga këto të fundit dhe ligjërohen në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

b) Në lidhje me burimin e deklaruar, një pjesë e huas në shumën 20.000 euro

**1.11** Subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, në rubrikën e detyrimeve financiare, ka deklaruar: *“Kontratë huaje pa afat, në formë shkresore, me qëllim blerje të një apartamenti banimi, e lidhur në datën 21.8.2009 për marrjen e një huaje në shumën 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%”*.

**1.12** Në pyetësorin standard<sup>9</sup> subjekti ka depozituar kontratën e huas e cila është lidhur mes shtetasve A. Q. (huadhënës) dhe G.O.(huamarrës), e cila daton më 21.8.2009.

**1.13** Subjekti në deklaratimet e saj në pyetësor vijimisht ka deklaruar, ashtu sikurse ka arsyetuar Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim KPA) në vendimin e bashkëshortit të saj. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar ligjshmërinë e aktit kontraktor, parashikimet kontraktore lidhur me afatin e shlyerjes së huas, si dhe mënyrën e sjelljes së kësaj shume nga shteti italian. Më ekzaktësisht lidhur me deklarinimin e fundit, subjekti ka shpjeguar se *sjellja dorazi, ndër vite, e shumës prej 20,000 euro, nga subjekti i lidhur, nuk mund të vërë në dyshim këtë deklarinim, në kushtet kur të vepruarit në këtë mënyrë është e lejuar dhe mund të konfirmohet nga udhëtimet e kryera prej tij në territorin e Republikës së Shqipërisë. Legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, nuk ka parashikuar asnjëherë ndonjë detyrim ligjor për kalimin e shumave në rrugë bankare midis dy individëve<sup>10</sup>. Në kushtet kur kjo shumë mbështetet në burime të ligjshme, e bën më të besueshëm veprimin, kundrejt një veprimi me bankë, që nuk mbulohet nga burime të ligjshme të subjektit të lidhur. Një indicie tjetër (ka deklaruar subjekti) që duhet të merret në konsideratë nga Komisioni, në favor të subjektit të rivlerësimit, është fakti që kjo hua, prej vitit 2013, është një hua e kthyer, fakt i cili hedh poshtë çdo dyshim mbi vërtetësinë e saj. Lidhja e kësaj kontrate me shkrim, është çmuar nga subjektet e kësaj marrëdhënie, jo për shkak të provueshmërisë së detyrimit me njëri tjetrin (për shkak të marrëdhënieve të posaçme që ekzistojnë midis tyre), por për shkak të detyrimit ligjor që unë dhe bashkëshorti im kishim si subjekte të rivlerësimit, në kuadër të deklaratimeve periodike dhe verifikimit të tyre. Kjo shumë është rrjedhojë e kursimeve vjetore të këtij të fundit, që siç do të sqarohet në vijim, dhe këto dërgesa nuk e kanë kaluar asnjëherë vlerën prej 1,000,000 lekë. Ky është i vetmi detyrim, që parashikon legjislacioni shqiptar, për kalimin e mjeteve monetare në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet pikave të kontrollit doganor. Konkretisht, ky detyrim është parashikuar në ligjin nr. 8610/2000, “Për parandalimin e pastrimit të parave”, dhe më pas, me ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”<sup>11</sup>, i cili në nenin 17 të tij, parashikon raportimin në organet doganore: “1. Çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn/largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat*

<sup>8</sup>Kursimet e bashkëshortit në vlerën 2.400.000 lekë, nuk janë analizuar, pasi ndaj këtij subjekti ka përfunduar procesi i rivlerësimit në të dyja shkallët e rivlerësimit.

<sup>9</sup> Dërguar subjektit me e-mail në datën 4.12.2019.

<sup>10</sup> Referuar edhe praktikës së konsoliduar nga KPK, sipas vendimit të formës së prerë me nr.158, datë 29.5.2019, për subjektin e rivlerësimit DH. L., në faqet 9 dhe 10 të vendimit.

<sup>11</sup>Burimi i informacionit- ligjet. Org.



*në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1,000,000 lekë ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese....” Sipas deklarimeve që z. A.Q., i ka dhënë bashkëshortit, shuma prej 20,000 euro, është sjellë nga ai dorazi, jo me anë të sistemit bankar. Kjo formë e sjelljes të të ardhurave nga paga, është vlerësuar prej tij si me më pak shpenzime, dhe përderisa nuk ka patur ndonjë ndalim për të vepruar në mënyrë të tillë. Kjo formë shpjegohet nga ana e tij dhe me faktin se në kushtet kur kishte dokumentacion të rregullt qëndrimi në Itali, ai vinte në Shqipëri, herë pas here, dhe dy tre herë brenda vitit. Sjellja dorazi e të ardhurave të emigrantëve shqiptarë, rezident ose jo në Shqipëri, është një fakt i njohur dhe i pranuar nga të gjitha institucionet shqiptare dhe organizmat ndërkombëtarë. Problematika që është trajtuar në këtë drejtim, nuk kanë qenë të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit, por nga burime të tjera të paligjshme, për të cilat është bërë dhe ndërhyrje here pas here në legjislacionin përkatës. Përkundrazi, për të ardhurat nga puna e realizuar në territorin e një shteti të huaj, legjislacioni tatimor apo marrëveshjet dypalëshe midis shteteve, kanë parashikuar edhe shmangien e tatimeve të dyfishta apo detyrimeve të tjera fiskale. Po kështu, nga ana tjetër nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për subjektin e rivlerësimit, për të dokumentuar mënyrën e ardhjes së kësaj shume në shtetin shqiptar, nga një shtetas shqiptar, përveç se provueshmërisë së vullnetit (me gojë apo me shkrim midis palëve) dhe dokumentimit të burimit të ligjshëm të prejardhjes së tyre.*

**1.14** Për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj huaje, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara nga shtetasi A. Q. për vitet 1999 – 2009, konkretisht:

- ekstraktin e llogarive të sigurimeve shoqërore, të lëshuar në datën 14.2.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (Istituto Nazionale Previdenza Sociale – INPS), për subjektin A. Q., i përkthyer dhe njëkohësisht edhe me vulën apostille, sipas parashikimeve të Konventës së Hagës, datë 5.10.1961;
- vërtetimin për ngarkesa zero, të lëshuar në datën 15.2.2019, nga Agjencia e të Ardhurave, sipas së cilës në këtë datë, subjekti A. Q., nuk ka ngarkesa ekzistuese pranë Zonës Territoriale të Reggio Emilia, i cili, gjithashtu, përmban përkthimin dhe vulën apostille, në zbatim të parashikimeve të Konventës së Hagës, datë 5.10.1961.

**1.15** Komisioni, pasi ka zgjeruar hetimin në analizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për shtetasin A. Q., ka marrë gjithashtu edhe dokumentacion<sup>12</sup> e administruar në dosjen e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. G. O..

**1.16** Në këtë drejtim, nga aksesi në sistemin *TIMS*, ka rezultuar se shtetasi A. Q. ka hyrë dhe ka dalë në territorin e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht dy deri në tre herë në vit për periudhën 2004 – 2009. Gjithashtu, në datën e nënshkrimit të kontratës së huas, rezulton të ketë qenë në Shqipëri.

**1.17** Komisioni e ka pyetur<sup>13</sup> subjektin për shtetasin A. Q. nëse ka pasur apo ka pasuri, nëse ka kryer investime në shtetin italian, e cila ka sqaruar se *ai ka jetuar me qira gjatë gjithë periudhës. Në fillim ka bashkëjetuar edhe me dy persona të tjerë, me të cilët ka ndarë në mënyrë të barabartë qiranë e shtëpisë dhe shpenzimet e tjera, ndërsa në momentin që është martuar, në vitin 2008, ka banuar me bashkëshorten e tij.* Për automjetet, ka deklaruar se aktualisht ka në pronësi automjetin me targa \*\*\*, i blerë në vitin 2015. Automjeti me targa \*\*\* është blerë në vitin 2011 dhe më pas është shitur. Për automjetin me targa \*\*\*, rezulton të jetë blerë shumë kohë më parë dhe z. A. Q. nuk e kujton vlerën e tij.

<sup>12</sup> Parashtrime për rezultatet e hetimit G. O., dokumentacion për të ardhurat e shtetasit A.Q., CUD (Certificazione unica dipendente).

<sup>13</sup> Pyetësor nr. 4 datë 8.10.2020.

**1.18** DPSHTRr-ja<sup>14</sup> ka konfirmuar pronësinë mbi automjetin me targa \*\*\*. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se automjeti është futur nga ky shtetas në territorin shqiptar, si dhe është zhdoganuar prej tij. Automjeti, sipas dokumentacionit doganor, ka kushtuar në vlerën 200.000 lekë dhe detyrimet doganore për zhdoganimin e tij në vlerën 151.110 lekë.

**1.19** Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionet publike<sup>15</sup> për shtetasin A. Q. nga ku në përgjithësi ka rezultuar se ky shtetas nuk figuron titullar i ndonjë pronësie të luajtshme apo të paluajtshme në territor vendi, apo në proces legalizimi, nuk rezulton titullar i ndonjë llogarie bankare, apo i regjistruar në ushtrimin e ndonjë biznesi dhe, për pasojë, as edhe në organet tatimore, nga viti 2012 e në vijim nuk i figuron emri në ndonjë listëpagesë, si dhe nuk rezulton të ketë kryer veprime noteriale.

**1.20** Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi A.Q. (i cili ka lidhje familjare me bashkëshortin e subjektit), sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, të dhënat e të cilës pasqyrohen në tabelën si vijon.

Tabela nr. 1

Viti	Të ardhurat <i>bruto</i> sipas CUD (1)	Të ardhura <i>neto</i> sipas INPS (2)	Detyrime fiskale sipas CUD (3)	Sigurime <sup>16</sup> sipas CUD (4)	Shpenzime qiraje sipas deklarimit të subjektit (5)	Shpenzime jetese sipas ISTAT <sup>17</sup> (6)	Blerje makine + shpenzime udhëtimi <sup>18</sup> (7)	Mundësia për kursim (8) = 1+2-3-4-5-6-7
2003	14,080	1,818	2,146	1,338	1,600	6,298	2,627	1,890
2004	16,606	2,395	2,881	1,578	1,600	6,624	100	6,218
2005	14,958	2,714	2,470	1,421	1,600	6,743	300	5,138
2006	17,680	1,714	3,222	1,674	1,600	6,986	200	5,712
2007	18,503	861	2,810	1,787	1,600	7,102	300	5,765
2008	16,265		627	1,545	4,800	11,996	100	-2,803
<b>TOTAL</b>	<b>109,371</b>	<b>10,528</b>	<b>14,985</b>	<b>10,414</b>	<b>16,000</b>	<b>51,669</b>	<b>3,627</b>	<b>21,919</b>

**1.21** Trupit gjykues, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se provohet me dokumentacion justifikues që shtetasi A. Q., person tjetër i lidhur, ka përfituar të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar huan e dhënë dhe se kjo shumë, në raport me shpenzimet e jetesës në shtetin italian, por edhe me gjithë ndalesat e tjera nga taksat, rezulton e mjaftueshme për të dhënë hua shumë prej 20.000 euro, konkluzion i cili përmbush kërkesat pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2020.

<sup>15</sup> Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar ASHK-së dhe përgjigje nr.\*\*\* prot., datë 2.12.2020, e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2; nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2020, Drejtorisë Vendore Zonat e Stimuluara; nr. \*\*\* prot., datë 25.11.20-20, Drejtorisë Vendore Elbasan; nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2020, e Njesisë së Kadastrës dhe Hartografisë; kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë së bashku me përgjigjet e ardhura; kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar DPPPParave dhe përgjigja nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2020; kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar RNSH-së dhe përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2020; kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar ISSH-së dhe përgjigjet përkatëse nr.\*\*\* prot., datë 9.11.2020; nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2020; nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2020; nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2020; kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020, drejtuar DPT-së dhe përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2020.

<sup>16</sup> Sipas CUD-it ka informacion për vitet 2006 dhe 2008 për shpenzimet e sigurimeve, për vitet e tjera, në mungesë të informacionit, ky shpenzim është përlllogaritur 9.5% e të ardhurave *bruto* CUD, duke u bazuar në raportin e viteve ku kjo e dhënë identifikohet.

<sup>17</sup> <http://dati.istat.it/Index.aspx?QueryId=17160>, deri në vitin 2007 janë përlllogaritur vetëm për një person, ndërsa në vitin 2008 për dy persona pasi huadhënësi është martuar.

<sup>18</sup> Bazuar në hyrje daljet në sistemin *TIMS* për shtetasin A. Q. . Çdo hyrje-dalje është përlllogaritur në vlerën 100 euro.

c) Në lidhje me burimin e deklaruar, të gjitha të ardhurat nga dhurimi në shumën 1.500.000 lekë

**1.22** Subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, në rubrikën e detyrimeve financiare, ka deklaruar: *“Dhurim i prindërve për shkak të kontributit në familje në vite, pas martesë dhe porositjes së një apartamenti banimi, në shumën 1.500.000 lekë”*.

**1.23** Në pyetësorin standard, subjekti ka sqaruar se: *“...deklaroj se nga ana e prindërve të mi më është bërë një dhurim në janar të vitit 2009, për shkak të porositjes së një apartamenti banimi, për shkak të kontributit të dhënë nga ana ime në familje në vitet 2002 – 2008 dhe për shkak të 30 vjetorit të ditëlindjes time (2.2.1979), në shumën prej 1,500,000 lekë. Kjo shumë ka shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit të porositur me aktmarrëveshjen datë 2.2.2009. Për shkak të marrëdhënieve të posaçme nuk kam lidhur ndonjë kontratë dhurimi. Lekët më janë dhënë dorazi, për shkak të marrëdhënieve të posaçme.*

*... pra, nga sa më lart, duke përfshirë vetëm<sup>19</sup> të ardhurat nga paga e ime dhe babait tim (paga e deklaruar), mendoj se mbulohet burimi i ligjshëm i këtij dhurimi. Dua të theksoj se shuma në thelb, janë kursimet që prindërit e mi kanë ruajtur nga kontributi im në familje deri në martesë.*

*... nga të dhënat nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, rezulton se për babanë tim, punëdhënësi i tij shoqëria “E\*\*\*\*” sh.p.k., ka deklaruar rregullisht në organet tatimore, këto të ardhura nga paga, për periudhën janar 2004 – shtator 2007:*

*Të ardhurat mbi të cilat është bërë deklarim nga punëdhënësi<sup>20</sup> për periudhën 2004 – shtator 2007 rezultojnë në vlerën 1.085.835 lekë”*.

**1.24** Komisioni, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, por edhe të administruar nga hetimi, kreu analizën financiare për të konkluduar nëse provohej mundësia e dhënies së shumës prej 1.500.000 lekësh vetëm me të ardhurat e subjektit për periudhën 2004 – 2008. Kjo, për arsyen sepse subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009 se dhurimi ishte bërë për shkak të kontributit të saj në familje, ndër vite, si dhe gjatë hetimit administrativ dhe në pyetësorin standard ku ka rideklaruar se burimi i shumës së dhuruar ishin të ardhurat e saj.

Tabela nr. 2

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vitet 2004 – 2008</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>3,788,682</b>
Të ardhura nga paga subjekti <sup>21</sup>	3,788,682
<b>Shpenzime</b>	<b>3,261,558</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	586,218
Shpenzime udhëtimi (TIMS)	223,229
Shpenzime qiraje	177,500
Kursime <i>cash</i>	500,000
Dhurimi	1,500,000
<b>Likuiditete në bankë</b>	<b>(2,160)</b>
<b>Diferenca</b>	<b>803,895</b>

<sup>19</sup> Subjekti deklaroi: *“Prindërit e mi kanë dhe të ardhura të tjera të fituara gjatë jetës nga puna e tyre, të deklaruara nga ana ime që me fillimin e detyrës në DPV-në e vitit 2004, por burimi i kësaj shume janë të ardhurat e mia”*.

<sup>20</sup> Përlllogaritjet janë kryer sipas pagës së deklaruar nga punëdhënësi në organet tatimore dhe sigurimet shoqërore, por paga faktike ka qenë shumë më e lartë. Babai i subjektit ka qenë me profesion mekanik dhe është deklaruar me minimalen jetike, fakt i cili është konstatuar prej tij vetëm në momentin e procedurave për lidhjen e pensionit.

<sup>21</sup> Vërtetim nr\*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**1.25** Trupit gjykues, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se provohet burimi i ligjshëm i shumës së dhuruar prej 1.500.000 lekë, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**1.26** Komisioni hetoi, gjithashtu, edhe për prindërit e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë e mundshme që mund të kishin krijuar në raport me shumën e dhuruar.

**1.27** Gjatë hetimit<sup>22</sup> rezultoi se prindërit e subjektit dhe vëllai i saj kishin blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 30.12.2008, një apartament banimi në vlerën 5.100.000 lekë ose 40.520 euro, të ndodhur në Y., Tiranë

**1.28** Komisioni e ka pyetur subjektin<sup>23</sup>, lidhur me fitimin e kësaj pasurie dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj, e cila ka sqaruar se kjo nuk është pasuri e saj, por e prindërve dhe vëllait (sikurse ka rezultuar nga kontrata e shitjes dhe regjistrimi hipotekor) dhe ka sqaruar se si burim ka shërbyer:

- shuma 1.400.000 lekë e krijuar nga shitja e një banese në Shkodër, në bashkëpronësi të prindërve, me kontratën e nr. \*\*\*, datë 8.8.2001;
- përdorimi i dy depozitave bankare, në të cilat prindërit kanë mbledhur kursimet nga gjithë punësimi i tyre ndër vite;
- dy automjete pune të babait, të cilat i ka pasur në pronësi dhe që nuk janë në qarkullim që nga viti 2002-2003 (i cili ka qenë me profesion mekanik dhe këto automjete janë shitur nga pjesë-pjesë personave të ndryshëm, për të cilat (subjekti ka deklaruar) nuk kam të dhëna për shkak të pamundësisë objektive, pasi babai ka ndërruar jetë);
- të ardhurat nga punësimi i vëllait migracion në Greqi që prej vitit 1998, me të cilat është mbuluar pjesa tjetër e shumës së paguar.

**1.29** Në analizim të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, por edhe shpjegimeve të dhëna, rezulton se për blerjen e apartamentit prindërit e subjektit kanë kryer likuidimet, si vijon:

- në datën 1.5.2008 kanë paguar vlerën 25.000 euro;
- në datën 14.6.2008 kanë paguar vlerën 10.000 euro;
- në datën 29.12.2008 kanë paguar vlerën 5.520 euro.

**1.30** Nga verifikimi i llogarive bankare, Komisioni ka konstatuar se prindërit e subjektit kanë pasur dy depozita në monedhën euro dhe dollarë, nga të cilat janë tërhequr në datën 21.4.2008, shuma 9.684,75 euro dhe në datën 5.5.2008, shuma 14.206 USD.

**1.30.i** Nga statement i “Raiffeisen Bank”<sup>24</sup> rezulton se në datën 11.7.2006 është maturuar depozita në euro në vlerën 6.026,9 euro. Në këtë llogari në datën 17.8.2007 rezulton një derdhje në shumën 3.400 euro dhe më pas totali i shumës së akumuluar është investuar përsëri në depozitë.

**1.30.ii** Në datën 7.7.2006 është maturuar depozita në dollarë, në vlerën 13.571,76 USD. Të dyja këto depozita në monedhat euro dhe dollarë janë tërhequr në vitin 2008, për të likuiduar blerjen e apartamentit.

**1.31** Subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues edhe për të ardhurat e vëllait M. N., emigrant në shtetin grek, që nga viti 2001.

<sup>22</sup> ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, konfirmon këtë fakt me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020.

<sup>23</sup> Pyetësor nr. 3, datë 17.9.2020 dhe dokumentacioni mbështetës.

<sup>24</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 3, datë 17.9.2020.

**1.31.i** Sipas përlllogaritjeve (nisur edhe nga rakordimi i tërheqjes së shumave dhe pagesave të kryera në favor të pasurisë) rezulton se prindërit e subjektit kanë pasur në dispozicion shumën 31.539,95 euro për blerjen e apartamentit në vlerën 40.520 euro. Kjo si rezultat i shumës:

- 1.400.000 lekë të ardhura nga shitja e pronës në Shkodër, në vlerën 11.365,25 euro, e cila është konvertuar me kursin mesatar të vitit 2008, sipas Bankës së Shqipërisë;
- depozita në shumën 9.684,75 euro;
- depozita në shumën 14.206 USD, e konvertuar me kursin mesatar të vitit 2008, sipas Bankës së Shqipërisë, rezulton në vlerën 10.489,95 euro;
- pjesa tjetër prej 8.980,05 euro (diferenca mes 40.520 – 31.539,95), duket se është mbuluar nga kursimet e vëllait emigrant.

**1.32** Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të të gjithë dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, krijon bindjen se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare për t'i dhuruar shumën 1.500.000 lekë, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

### **Në lidhje me likuidimin e pasurisë**

**1.33** Kjo pasuri fillimisht konfirmohet me anë të aktmarrëveshjes<sup>25</sup> nr. \*\*\* rep., datë 2.2.2009, me palë porositëse shtetasin G. O. dhe i porosituri shoqëria ndërtimore “H\*\*\*” sh.p.k. Vlera e apartamentit: 67.680 euro.

Sipas aktmarrëveshjes, në nenin 2, parashikimi për likuidimin e kësaj pasurie ka qenë si vijon:

- z. G.O. do të paguajë shumën 15.000 euro me hartimin e kësaj kontrate;
- z. G. O. do të paguajë shumën 25.000 euro deri në maj të vitit 2009;
- z. G. O. do të paguajë shumën 15.000 euro deri në dhjetor të vitit 2009;
- z. G. O. do të paguajë shumën 12.680 euro me dorëzimin dhe mbarimin e punimeve dhe lejen e shfrytëzimit deri më 31.5.2010

**1.34** Subjekti në pyetësorin standard<sup>26</sup> ka sqaruar mbi mënyrën e likuidimit të shumës. Subjekti ka saktësuar se pagesën në shumën 32,680 euro, shlyer me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2009, e kanë paguar në një shtrirje kohore korrik 2009 – dhjetor 2009 dhe përkatësisht në mars të vitit 2009 ka deklaruar se janë shlyer 20,149 euro, në korrik të këtij viti janë shlyer 5,000 euro, në shtator të vitit 2009 janë shlyer 5,000 euro dhe në dhjetor është shlyer shuma 2,531 euro.

**1.35** Për pagesat e vitit 2009, subjekti ka sqaruar se: *“Me mandatin nr. \*\*\*, datë 21.3.2008<sup>27</sup>, nga ana e shoqërisë ‘H\*\*\*’ sh.p.k., na është lejuar të paguajmë deri në fund të vitit 2009, një shumë prej 32,680 euro, nga 40,000 euro të parashikuar në kontratë. Pra, si rrjedhojë, në muajin mars është lëshuar, për provueshmëri dhe për lehtësi në pagesën në vijim të kështit të dytë, mandati nr. \*\*\*, datë 21.3.2009 (i cili sipas kontratës përmbledhë dy këste). Në fillim është paguar shuma që ne kishim në euro, deri në atë moment, pra shuma 20,149 euro (nga kursimet në vitet paraardhëse dhe dhurimi). Në fund të korrikut të vitit 2009, është paguar një shumë tjetër prej 5,000 euro nga kursimet gjatë vitit, që përkojnë me një pjesë të kursimeve të këtij viti në vlerën 5,000 euro, konvertuar kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të muajit korrik 2009 – 129.656, është në shumën 648,280 lekë. Në datën 21.8.2009, me formalizimin e kontratës së huas me shkrim në datën 21.8.2009, është marrë nga z. A. Q., vlera prej 20,000 euro. Në shtator është paguar dhe një shumë prej 5,000 euro nga huaja. Nga fund viti, dhjetor i vitit 2009, është paguar totalisht shuma e mbetur e përcaktuar në*

<sup>25</sup> Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>26</sup> Datë 4.12.2019.

<sup>27</sup> Viti 2008 duhet të jetë lapsus nga subjekti sepse mandatarkëtimi mban vitin 2009.

*mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2009, që duhet të ketë qenë<sup>28</sup> në vlerën rreth 2,531 euro<sup>29</sup>, e cila është kthyer në euro, duke shfrytëzuar kurse të favorshme, por për llogaritje po i referohem kursit mesatar të dhjetorit të vitit 2019, në vlerën 137.17, pra, gjithsej 347,177 lekë. Kjo shumë është paguar nga kursimi i deklaruar prej 1,400,000 lekë e vitit 2009”.*

**1.36** Komisioni, nisur nga deklarimi i subjektit, me synim ezaurimin e plotë të mënyrës së kryerjes së pagesave, bazuar në vendimin e ndërmjetëm, administroi edhe korrespondencën e mbajtur me shoqërinë “H\*\*\*” sh.p.k., marrë në dosjen e subjektit të rivlerësimit G. O. . Në përgjigje, konstatohet se shoqëria ka deklaruar<sup>30</sup> datat e pagesave, shumat përkatëse, si dhe ka depozituar mandatarkëtimet të cilat mbështesin deklarimin e subjektit. Nga verifikimi i mandateve të depozituara nga shoqëria u konstatua se të gjithë pagesat e bëra rakordojnë me deklarimet e subjektit, duke përfshirë këtu edhe pagesën e kryer me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, në vitin 2009, për sa i përket shumës 32.680 euro. Dallimi i vetëm i konkluduar në këtë rast, është fakti se subjekti, shumën e mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2009, e deklaroi të shlyer në disa këste, deri në fund të vitit 2009 dhe jo të menjëhershme.

**1.37** Gjithashtu, Komisioni,<sup>31</sup> për një hetim objektiv, i ka kërkuar edhe një herë shoqërisë “H\*\*\*” sh.p.k. të informojë mbi mënyrën e shlyerjes së pagesave për këtë pasuri, si dhe të depozitojë librin e arkës dhe çdo dokumentacion tjetër të vlerësuar në lidhje me të. Në përgjigjen<sup>32</sup> e sjellë rezultoi se për këtë pasuri është paguar shuma 63.680 euro dhe se nuk është paguar kësti i fundit prej 4.000 euro, për shkak se ky apartament është dorëzuar përtej parashikimit kontraktor dhe se sipas praktikave të shoqërisë shuma nuk mbahet në ndërmarrje, por dorëzohet në përputhje me aktmarrëveshjen në një kohë të mëvonshme në banka të nivelit të dytë dhe reflektohet në librin e arkëtimeve nga shitjet. Shoqëria ka depozituar, gjithashtu edhe dokumentacion mbështetës mbi informacionin e dhënë.

**1.37.i** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstatoi se pagesat, sikurse informon edhe shoqëria, bëhen në numrin e llogarisë në bankë pranë shoqërisë ndërtuese “H\*\*\*” sh.p.k., ose në arkë kundrejt lëshimit të mandatpagesës përkatëse, parashikim ky i bërë në nenin 2, të aktmarrëveshjes datë 2.2.2009, nënshkruar midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë, për porositjen e apartamentit.

**1.37.ii** Në analizë të dokumentacionit të depozituar rezultoi se pagesat e konfirmuara me mandatarkëtime për periudhën 2009 – 2011, shoqëria i ka derdhur në bankë në emër të subjektit të rivlerësimit (bashkëshortit të saj) gjatë periudhës 2009 – 2013. Më konkretisht, u vërejt se në vitin 2009 shoqëria kishte derdhur në bankë nga shuma e arkëtuar 47.680 euro, vetëm 11.400 euro, në vitin 2010 nga shuma e arkëtuar 12.000 euro, shumën 12.900 euro, në vitin 2011 megjithëse subjekti kishte arkëtuar 4.000 euro, shoqëria kishte derdhur 17.120 euro, në vitin 2012 dhe 2013, kohë kur subjekti nuk ka kryer shlyerje për llogari të shoqërisë, kjo e fundit kishte derdhur në bankë përkatësisht shumën 17.120 dhe 5.000 euro dhe që në total rezultoi e derdhur shuma 63,540 euro. Po ashtu, shoqëria në përgjigjen e dhënë përmbri pagesës prej 32.680 euro, me mandatarkëtimin nr. 54, ka saktësuar periudhën e shlyerjes 21.3.2009 – 31.12.2009.

**1.38** Komisioni, deri në fazën e rezultateve të hetimit, konkludoi në kryerjen e analizës financiare duke përlllogaritur në mënyrë strikte, sipas mandatarkëtimeve, këstet e paguara përgjatë vitit 2009, përkatësisht shumat 15.000 euro, datë 31.1.2009 dhe 32.680 euro, datë 21.3.2009. Meqenëse kursi i këmbimit ka pasur ndryshime të konsiderueshme gjatë vitit 2009,

<sup>28</sup> Llogaritjet bëhen në mënyrë hipotetike, pasi nuk mbahen mend koha e saktë dhe kurset e këmbimit.

<sup>29</sup> Për këtë shumë janë përdorur kursimet dhe jo huaja për shkak se në atë kohë euroja por rritej, dhe në të ardhurat po i kthenim në euro.

<sup>30</sup> Përgjigje nga shoqëria “H\*\*\*” sh.p.k. datë 26.1.2018 dhe dokumentacioni mbështetës.

<sup>31</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2020.

<sup>32</sup> Shkresë, datë 4.12.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

Komisioni vlerësoi që të marrë si kurs këmbimi kursin mesatar<sup>33</sup> sipas Bankës së Shqipërisë. Analiza është kryer në fund të muajit mars, pasi për këstin e parë (datë 31.1.2009) prej 15.000 euro, subjekti ka pasur në dispozicion shumën e dhuruar nga prindërit prej 1.500.000 lekësh, si dhe kursimet e saj dhe të bashkëshortit në shumën 2.900.000 lekë (500.000 lekë të subjektit dhe 2.400.000 lekë të bashkëshortit). Në këtë qasje, nga analiza e kryer, Komisionit i rezultoi se subjekti gjendej në pamundësi financiare në shumën 1.352.894 lekë.

**1.38.i** Në vijim, për pagesat e vitit 2010, rezultoi se subjekti ka përdorur pjesën e mbetur nga huaja e marrë shtetasit A. Q. . Ndërsa, për këstin e fundit, të paguar në vitin 2011, janë përdorur kursimet e akumuluar nga subjekti dhe bashkëshorti.

**1.39** Sipas deklarimit të subjektit, huaja e marrë i është shlyer me këste në vitet 2011 – 2013, shtetasit A. Q. për blerjen e këtij apartamenti.

Komisioni, në kontekstin e këtij deklarami dhe të provueshmërisë së mundësisë financiare për të realizuar shlyerjen e huas, kreu analizën financiare për vitet 2009 – 2013, nga momenti i investimit në këtë pasuri deri te shlyerja e saj, nga ku rezultoi se subjekti gjendej në pamundësi financiare, përkatësisht, në shumën -1,510,695 lekë në vitin 2011 dhe në shumën -1,113,460 lekë në vitin 2013.

➤ Në lidhje me burimin e pasurisë në deklaratën *Vetting*, cituar shuma 2.000 euro, e derdhur në llogari në datën 13.01.2017, me burim nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit ndër vite.

**1.40** Komisioni, për sa i përket kursimeve të akumuluar, është shprehur në pikën 3, në këtë vendimmarrje. Nga përlllogaritjet financiare është vërejtur se subjekti, në fund të vitit 2016, gjendet me gjendje *cash* në vlerën 8.385.835 lekë, shumë kjo, mëse e mjaftueshme për të mbuluar derdhjen prej 2.000 euro, datë 13.1.2017.

**1.41** Trupi gjykues, në kushte të tilla, konstaton se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të shumës prej 2.000 euro, e përdorur për shlyerjen e pasurisë së deklaruar në deklaratën *Vetting*.

### **Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit**

**1.42** Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit për shkak të funksionit të saj, subjekti është pyetur<sup>34</sup> nëse ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasit<sup>35</sup> me të cilët ka lidhur kontratat e shitblerjeve të apartamenteve dhe, në përgjigjen e dhënë, ka konfirmuar se as ajo dhe as bashkëshorti, në kryerjen e detyrës, nuk kanë gjykuar apo hetuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasit me të cilët kanë lidhur kontratën e shitblerjes së pasurisë dhe as me shoqërinë ndërtimore “H\*\*\*” sh.p.k., apo me përfaqësuesit e kësaj shoqërie me këtë cilësi apo edhe si individ.

**1.43** Komisioni ka mbajtur korrespondencë<sup>36</sup> edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit nga përgjigjet e të cilave, në asnjë rast, nuk është konfirmuar zhvillimi i ndonjë procesi gjyqësor me këto palë ndërgjyqëse.

**1.44** Në të tilla kushte, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

<sup>33</sup> Për muajin janar të vitit 2009, 1 euro = 125.18 lekë dhe për muajin mars të vitit 2009, 1 euro = 130.67 lekë.

<sup>34</sup> Dërguar me tekst të e-mail-it, datë 20.10.2020.

<sup>35</sup> Shtetasit A.D., D. T., I. T., S. K. dhe shoqëria “H\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësuese znj. D. .

<sup>36</sup> Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe përgjigje nr...prot., datë... e po kësaj gjykatë, kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë dhe përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. \*\*\*prot., datë 18.11.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**1.45** Në konkluzion të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se nga analiza financiare e kryer: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.352.894 lekë për të shlyer këstet deri në muajin mars dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; si dhe (ii) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 2.645.858 lekë, përgjatë viteve 2011 - 2013, për të shlyer huan, të shtonte kursimet vit pas viti, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës<sup>37</sup> për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni**

**1.46** Subjekti, paraprakisht, është shprehur se bashkëshorti i saj i ishte nënshtruar procedurës së rivlerësimit nga Komisionit me disponim vendimi për konfirmimin e tij në detyrë. Vendimi i Komisionit për bashkëshortin ishte ankimuar nga Komisioneri Publik, mbi bazën e të cilit pas shqyrtimit të këtij ankimi<sup>38</sup>, Kolegji kishte arritur në konkluzionin se bashkëshorti i saj ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen *cash* dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.760.497 lekë.

Në këtë kontekst, subjekti është shprehur se Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa aspekte procedurale të rëndësishme, në përmbushje të parimit të sigurisë juridike, parim i cili duhet të qëndrojë në bazë të çfarëdolloj procedure gjyqësore apo administrative.

Subjekti ka parashtruar: “... *hetimi i Komisionit bazohej për të njëjtat pasuri, fakte dhe prova, për të cilat unë kam dhënë shpjegime, së bashku me bashkëshortin tim, gjatë procedurës së parë të rivlerësimit. Për të gjitha faktet dhe rrethanat, objekt i asaj procedure administrative hetimi dhe gjykimi, sot ka një vendim të formës së prerë, vendim i cili ka zgjidhur, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë përfundimtare, të dhënat për kriterin e pasurisë, jo vetëm për bashkëshortin tim, por dhe të dhënat e mia si person i lidhur*<sup>39</sup>. Ky vendim i ka dhënë zgjidhje njëkohësisht edhe procedurës administrative për kriterin e pasurisë, procedurë e cila do të zhvillohej ndaj meje, në të ardhmen si subjekt rivlerësimi. Sipas subjektit, një aspekt i tillë procedural dhe material ishte trajtuar dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili në mënyrë të qartë dhe të shprehur e ka përfshirë atë në arsyetimin e vendimit të tij<sup>40</sup>. Me anë të këtij përfundimi, Kolegji i ka dhënë zgjidhje çështjes së ndërvarësisë së procedurave administrative të hetimit nga Komisioni dhe të gjyqimit nga Kolegji, kur të dy subjektet janë subjekte të ligjit të rivlerësimit kalimtar.

*Me vendimin nr. 20, datë 31.7.2019, Kolegji ka argumentuar se: ‘78. Në funksion të një shqyrtimi në tërësi të kësaj çështjeje, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe sqaron se ky vendim në asnjë mënyrë nuk paragjykon të drejtën e saj për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk do të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, të cilin bashkëshortja e subjektit ka të drejtë ta ketë, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së saj dhe në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit’. Po ashtu, paragrafi 78, i vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit duhet të lexohet dhe interpretohet nën dritën e dy parimeve kryesore, të cilët janë gurë themeli për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës<sup>41</sup> dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat*

<sup>37</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>38</sup> Referojuni ankimit të Komisionerit Publik datë 15.11.2018.

<sup>39</sup> Subjekti sqaron: “Në kushtet kur unë nuk zotëroj pasuri veçmas, fakt i vërtetuar dhe nga rezultatet e dy procedurave administrative hetimore të zhvilluara ndaj meje.

<sup>40</sup> Nëse nga Kolegji do të çmohej se procedurat nuk do të kishin ndërvarësi, nuk kishte pse të trajtonte këtë fakt në vendimin e tij.

<sup>41</sup> Neni 42 i Kushtetutës parashikon se: “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë,



e Njeriut<sup>42</sup>. Ato janë parimi i sigurisë juridike dhe parimi i dëgjimit drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e paanshme. Parimi i sigurisë juridike sipas subjektit kërkon, midis të tjerave, që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim<sup>43</sup>. Ndryshimi i praktikës së Gjykatës Kushtetuese për shtrirjen e sigurisë juridike edhe ndaj vendimeve gjyqësore erdhi si pasojë e vendimeve të GJEDNJ-së me palë shtetin shqiptar, ku ajo deklaroi se siguria juridike duhet të përfshijë edhe veprimtarinë e gjykatave<sup>44</sup>. Në vazhdim të paprekshmërisë së vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se në harmoni me parimin e sigurisë juridike ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata), parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: ‘Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe<sup>45</sup>’.

Në vendimin nr. 24/2008, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: ‘Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Prandaj, në vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 ajo ka pranuar se ‘... vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuarës ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim’. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila në çështjen Kehaya and others v. Bulgaria shprehet se ‘... në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë, është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një vendim përfundimtar është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat, ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë’. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe në standardin e vendosur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer

---

ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

<sup>42</sup> Neni 6 i KEDNJ-së - E drejta për një proces të rregullt – “1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...”

<sup>43</sup> Vendim nr. 7/2009, i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>44</sup> Shihni për më tepër çështjet Xheraj, Balliu, Beshiri etj. Më hollësisht praktika e GJEDNJ-së trajtohet më poshtë në nënçështjen e GJEDNJ-së për Gjykatën Kushtetuese shqiptare.

<sup>45</sup> Siç është procedura e rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj”.

Pas parashtrimeve juridike, në konkluzion subjekti është shprehur se: “... Kolegji i Posaçëm i Apelit, në zbatim të parimeve të sipërcituara i ka dhënë zgjidhje procedurës së saj të rivlerësimit, duke vendosur:

-Të përfunduar hetimin tim për kriterin e pasurisë, për të gjitha ato marrëdhënie, të dhëna dhe pasuri, të cilat kanë qenë objekt hetimi, analizimi dhe vlerësimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioneri dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, në funksion të përmbushjes së të drejtave të mia kushtetuese: (a) për një hetim dhe gjykim brenda një afati të arsyeshëm, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit; (b) për një gjykatë të paanshme<sup>46</sup>.

-Të konsiderojë gjë të gjykuar kriterin e pasurisë, të bazuar mbi të njëjtat të dhëna, fakte dhe prova, duke përcaktuar shprehimisht një hetim të kufizuar administrativ për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, vetëm mbi provat që i përkasin çështjes sime, pra që kanë lidhje me pasuri të miat të pahetuara dhe të disponuara veçmas, si dhe me dy kriteret e tjera, atë të pasurisë dhe të figurës.

-Të zbatohet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit parimi i proporcionalitetit, parim i cili mund të merret në konsideratë vetëm pas një hetimi të plotë të të tri kriterëve në tërësi dhe jo mbi bazë të një kriteri të vetëm, i cili në këtë rast, siç do të argumentohet në vijimësi të këtij qëndrimi, është gjë e gjykuar dhe cenon të drejtën time për një proces të rregullt ligjor<sup>47</sup>”.

Subjekti, po ashtu, ka nënvizuar zbatimin e parimit të proporcionalitetit<sup>48</sup> dhe objektivitetit përmes analizimit<sup>49</sup> të gjendjes së pasurive të deklaruar prej saj në deklaratën Vetting, duke referuar në vendimin e Kolegjit për bashkëshortin dhe duke u shprehur se: “... theksimi i këtyre parimeve, në vendimmarrjen e Kolegjit, ka si qëllim të vetëm të tregojë se konkluzioni i arritur ndaj bashkëshortit në këtë vendim, nuk mund të jetë shkak edhe për marrjen e masës disiplinore ndaj meje. Vendimmarrja e Komisionit, për procesin e rivlerësimit ndaj meje, duhet të bazohet, vetëm në prova që i përkasin çështjes sime, pra, që nuk janë të lidhura me procesin e rivlerësimit të bashkëshortit, të cilat mund të jenë vetëm provat që administrohen në procesin e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, për sa kohë unë nuk zotëroj asnjë pasuri veçmas, siç u provua gjatë kësaj procedure. Atëherë, si mund të jetë shkak diferenca deri në 1.700.000 lekë për shkarkimin e dy magistratëve? Nëse do të veprohej ndryshe, përveç parimit të proporcionalitetit, do të cenohej rëndë edhe parimi i barazisë përpara ligjit”.

➤ Në lidhje me përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 1.352.894 lekë për të shlyer këstet deri në mars të vitit 2009, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare

Subjekti ka parashtruar faktet, referuar deklarimeve të saj periodike vjetore të vitit 2009, parashikimet lidhur me likuidimet e kësteve sipas aktmarrëveshjes së nënshkruar mes palëve, deklarimeve gjatë hetimit administrativ dhe të dhënave të mandatarkëtive të konfirmuara nga shoqëria “H\*\*\*” sh.p.k., si për subjektin e saj ashtu edhe për bashkëshortin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

<sup>46</sup> “Kolegji i Posaçëm i Apelit ka në përbërje të tij 7 anëtarë dhe 2 anëtarë zëvendësues. Në rast të shkarkimit tim mbi kriterin e pasurisë sipas këtij raporti, Kolegji, objektivisht nuk mund të më sigurojë një gjykatë të paanshme, pasi 5 nga 7 anëtarët e tij kanë gjykuar, analizuar dhe vlerësuar një herë rrethanat dhe faktet objekt hetimi, në lidhje me kriterin e pasurisë. Po ashtu e kundërta, nëse bashkëshorti im do të ishte konfirmuar.

<sup>47</sup> Në këtë aspekt çdo pretendim im kundër vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nuk mund të zgjidhet në këtë proces nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por vetëm me anë të procedurës ligjore të pikës 8, të nenit F, të Kushtetutës, në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>48</sup> Subjekti referon një sërë vendime të Komisionit të paankimuar, ku është zbatuar parimi i proporcionalitetit.

<sup>49</sup> Referojuni f. 30-31 të prapësimeve të dërguara nga subjekti datë 5.1.2021.

Në vijim, në mënyrë konkluzive, subjekti është shprehur se: “Marrëdhënia kontraktore e krijuar midis bashkëshortit tim dhe shoqërisë ‘H\*\*\*’ sh.p.k., me aktmarrëveshjen e datës 2.2.2009, nuk është një marrëdhënie juridike shitblerjeje e një pasurie, por një kontratë sipërmarrje, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e porositësit dhe shoqëria, në cilësinë e sipërmarrësit. Pagesat e kryera janë një paradhënie e porositësit ndaj sipërmarrësit për ndërtimin e një objekti në të ardhmen, si rrjedhojë kanë një regjim si juridik dhe kontabël të ndryshëm nga shitblerja. Pagesat e kryera nga kjo marrëdhënie nuk mund të pasqyrohen në librat e shitblerjeve të shoqërisë ndërtuese dhe trajtohen ndryshe nga legjislacioni tatimor në fuqi në pagesën e detyrimeve tatimore.

Aktmarrëveshja e datës 2.2.2009 është një parashikim i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, që do të ndodhë në të ardhmen, por jo konfirmimi i një rrethane faktike që ka ndodhur tashmë. Në këtë kuptim, këto afate mund të konsiderohen si orientuese për palët nënshkruese dhe nuk kanë fuqinë e provueshmërisë së këtij kalendari për shlyerjen e shumave, për sa kohë flitet për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen<sup>50</sup>.

Palët në një marrëdhënie kontraktore udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të ushtrojnë të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët, siç konfirmon edhe shoqëria ‘H\*\*\*’ sh.p.k., në shkresën e saj të datës 20.7.2018<sup>51</sup>. Në këtë kontekst, mandati nr. \*\*\*, datë 21.3.2009, ka ndryshuar planin e pagesave të parashikuara në aktmarrëveshjen datë 2.2.2009, duke pasqyruar një vullnet tjetër kontraktor midis palëve. Me këtë mandat, të lëshuar në mënyrë të njëanshme dhe të paguar rregullisht nga bashkëshorti im, shoqëria ndërtuese: ka ndryshuar madhësinë e këstit që do të paguhej nga 40,000 euro në 32,680 euro (pasi dhe huaja nuk ishte e sigurt që do të merrej në kohë); nuk ka ndryshuar afatin e pagesës së kësteve deri në muajin dhjetor 2009 të parashikuar në kontratë; ka marrë në konsideratë pamundësinë tonë për pagesën e gjithë shumës prej 40,000 euro, sipas parashikimit kontraktor<sup>52</sup>. Pra, pagesa e plotë është bërë në momentin që subjektit i janë krijuar likuiditete të mjaftueshme, si nga huaja, e marrë në muajin gusht të vitit 2009, si dhe nga kursimet e vitit 2009, deri në muajin dhjetor 2009.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit<sup>53</sup>, vlerësoj se ‘mandatarkëtimi’ nuk është një dokument kontabël i parashikuar nga legjislacioni fiskal, por është një shkresë e thjeshtë, që është përdorur rëndom nga shoqëritë tregtare për të dokumentuar një fakt, rrethanë apo vullnet, për të cilin ajo ka rënë dakord, për efekt provueshmërie dhe lehtësi veprimi, në transaksione me të tretët. Në rastin konkret provohet se:

- Sipas aktmarrëveshjes së datës 2.2.2009, nuk parashikohej asnjë pagesë në muajin mars 2009. Sipas saj, kësti i dytë do të paguhej në muajin maj 2009 dhe kësti tjetër në muajin dhjetor 2009.

- Transaksionet bankare të shoqërisë provojnë atë që shoqëria ka deklaruar në lidhje me mandatin nr. \*\*\*, datë 21.3.2009.

- Deklarimet e mia dhe të bashkëshortit tim në DVP –të e vitit 2009<sup>54</sup> përputhen plotësisht me deklaratimet e shoqërisë, si për kohën dhe burimin e pagesës, shumën e kësteve të paguara për vitin 2009 dhe me kohën e marrjes së huas. Këto deklarime duhet të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika

<sup>50</sup> Shihni paragrafin 40, të vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

<sup>51</sup> Shihni paragrafin 40, të vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

<sup>52</sup> Vetëm në muajin gusht mundësohej marrja e huas në vlerën prej 20.000 euro nga z. A. Q. .

<sup>53</sup> Sipas Komisionit nuk përbën logjikë të pritët një mandatarkëtim për pagesat që do të kryhen në të ardhmen, për sa kohë mes palëve ka qenë e nënshkruar një aktmarrëveshje, ku është parashikuar plani i pagesave.

<sup>54</sup> Dy deklaratat e pasurisë bashkëlidhur prapësimeve në cilësinë e provës.

5, e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: ‘Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit<sup>55</sup>’.

Së fundi, siç u theksua edhe më lart, unë kam qenë pjesë e procedurës së rivlerësimit të bashkëshortit tim G.O., në cilësinë e personit të lidhur. Vendimi nr. 20, datë 31.7.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>56</sup>, në lidhje me këtë pretendim, është përfundimtar dhe i detyrueshëm jo vetëm për subjektin e rivlerësimit, por edhe për mua si person i lidhur dhe të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera, të cilat do të ndeshen me një pretendim të tillë. Sipas këtij vendimi, Kolegji ka vlerësuar se deklarimi i faktit që të gjitha kursimet në vite, deri në datën 31.12.2009, janë përdorur si burim për pagimin e këstit, përfshin edhe shumën prej 1,400,000 lekësh, të deklaruar si kursim cash i atij viti. Duke përdorur dy konkluzionet e tij të shprehura në vendim, Kolegji ka kryer analizën financiare për vitin 2009, në përfundim, të së cilës ka konstatuar një tepricë pozitive prej 416.900 lekësh, në ndryshim nga sa pretendonte Komisioneri Publik për një mungesë të burimeve të ligjshme për shumën prej 1.041.085 lekësh<sup>57</sup>’.

**1.47** Në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti ka pretenduar: (i) përlllogaritjen e shumës së pagave të marra gjatë vitit kalendarik sipas *statement*-it bankar dhe jo sipas vërtetimeve të institucioneve përkatëse punëdhënëse; (ii) përfshirjen në totalin e të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010, shumën 240.000 lekë si rezultat i shitjes së automjetit tip “Volkswagen \*\*\*”; (iii) rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit për bashkëshortin, pasi shpenzimet ishin mbuluar nga organizatorët; (iv) marrjen në konsideratë të vlerave të gjendjes *cash*, sipas deklarimeve të kryera gjatë hetimit administrativ dhe sipas analizës së kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

#### **Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

**1.48** Trupi gjykues në këtë analizë, paraprakisht, ka vlerësuar të argumentojë lidhur me pretendimin e subjektit mbi aspektin procedural, teksa shprehet se duhet konsideruar si gjë e gjykuar kontrolli i kriterit të pasurisë, bazuar mbi të njëjtat të dhëna, fakte dhe prova, duke cilësuar shprehimisht një hetim të kufizuar administrativ për Komisionin, në kushtet që ekziston një vendim i formës së prerë për bashkëshortin e saj.

**1.48.i** Trupi gjykues vlerëson se nuk është përpara zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*), për sa arsyetohet në vijim:

- Ligji nr. 76/2016 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se subjektet e rivlerësimit janë: “... pika 3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryespektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* pika 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. pika 6. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm”.

- Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, rivlerësimi i bashkëshortit të subjektit është kryer nga një trup i pavarur i Komisionit dhe, po ashtu, nga një trup tjetër i shortuar dhe i pavarur për subjektin e rivlerësimit.

<sup>55</sup> Shihni paragrafin 42, të vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>56</sup> Një kopje e vendimit bashkëlidhur në cilësinë e provës.

<sup>57</sup> Shihni paragrafin 46, të vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Në këtë kontekst, parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, për kryerjen e këtij procesi e lidhin çështjen e rivlerësimit për çdo subjekt dhe ligjvënësi<sup>58</sup> për këtë ka parashikuar dispozitat përkatëse ligjore, të cilat veprojnë individualisht ndaj secilit prej tyre. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është dhënë vetëm për bashkëshortin e subjektit dhe subjekti i rivlerësimit është bërë pjesë e këtij procesi vetëm në rrethanat ligjore të parashikuara nga ky ligj, ku ka pasur statusin e personit të lidhur, çka do të thotë se subjekti nuk është palë për të cilën Kolegji është shprehur me një vendimmarrje për të, por ka qenë pjesë e procesit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

- Në respektim të parimeve të paanësisë, Komisioni ka kryer një hetim të pavarur për subjektin e rivlerësimit sikurse rezulton edhe nga faktet dhe provat e administruara. Ky është një ndër argumentet bazë nga të cilët paraprihet trupi gjykues në hetimin e kryer, ndërsa pretendimi i subjektit se ndodhemi përpara gjësë së gjykuar sa i përket kriterit të pasurisë do të përbënte paragjykim për hetimin. Standardi i gjësë së gjykuar, i lidhur me veprimin e ndërmarrë, pra, me vendimmarrjen ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndikon drejtpërdrejtë në palën ndaj të cilës vendimi do të ekzekutohet, pra, ndaj bashkëshortit të saj. Për rrjedhojë, vendimmarrja e KPA-së nuk ekzekutohet ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, edhe parimi i gjësë së gjykuar nuk gjen vend në këtë proces rivlerësimi.

- Trupi gjykues, në këtë çështje, vlerëson se vendimet e Kolegjit, në jurisprudencën e tyre, orientojnë Komisionin në përputhje me pikën 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, çka do të thotë se ato mbahen në konsideratë për sa mund të jenë të zbatueshme nisur nga tërësia e rrethanave ligjore e faktike të çështjes konkrete “objekt rivlerësimi”.

**1.49** Për sa i takon çështjes objekt vlerësimi lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, si dhe parashkrimeve të tij në prapësime, lidhur me pamundësinë financiare në shumën 1.352.894 lekë për të shlyer këstet deri në muajin mars, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, arsyeton si vijon:

**1.49.i** Në rezultatet e hetimit administrativ, ky konkluzion, rezultoi i tillë, në kushtet e qëndrimit të kryerjes së pagesës së këstit të dytë në vlerën 32.680 euro, në datën 21.3.2009, sikurse pasqyrohet në mandatarkëtimin nr. 54.

Trupi gjykues, në vlerësimin e kësaj çështjeje, ka çmuar provat në tërësi për të krijuar bindjen lidhur me vërtetësinë e deklaramentit të subjektit se kjo shumë është shlyer e shtrirë në kohë deri në fund të vitit 2009. Në këtë drejtim ka rezultuar se:

- a) nga deklaramentet e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2009, rezulton e dhëna se kjo shumë është shlyer përgjatë vitit 2009, deri më 31.12.2009;
- b) në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të gjitha kursimet *cash*, ndër vite, dhe po në të njëjtën rubrikë ka deklaruar edhe kursimet *cash* të realizuara për vitin 2009, pra edhe ato të krijuara përtej marsit të vitit 2009;

---

<sup>58</sup> Neni 48 - Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysht *gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit*. Neni 49 - Mjetet për kërkimin e provës 1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Posaçëm i Apelit ka të drejtë: (a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të pikës 2, të nenit 3, të këtij ligji; (b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit.

- c) në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar si burim krijimi, një pjesë të huas së marrë në vitin 2009, e cila u faktua se është marrë vetëm në gusht të vitit 2009, pra, përtej muajit mars 2009;
- d) në të dyja përgjigjet e shoqërisë “H\*\*\*\*” sh.p.k. sqarohet dhe saktësohet se pagesa e pasqyruar në mandatarëkëtimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2009, është shlyer përgjatë vitit 2009;
- e) nga të dhënat e hetimit nuk rezultoi që palët kontraktore të kenë pasur kundërshti ndaj njëra-tjetrës lidhur me pagime apo mospagime të shumës së kontraktuar për porosinë e apartamentit, qoftë në rrugë gjyqësore apo edhe administrative;
- f) sipas librit të arkës së shoqërisë i vënë në dispozicion prej saj, u vërejt se derdhjet e shumave në bankë nuk përkonin në asnjë rast me shumën e pasqyruara në mandatarëkëtimet përkatëse, nuk përkonin me datat e lëshimit të mandateve dhe as me kalendarin e pagesave të pasqyruara në kontratën e porosisë së apartamentit;
- g) në ndryshim nga konkludimet e mësipërme, shoqëria, shumën e shlyera nga bashkëshorti i subjektit, i ka derdhur në shtrirje kohore deri në vitin 2013, kur në fakt ato kishin përfunduar së paguari që në vitin 2011;
- h) në secilin rast duket se palët kanë zgjidhur të veprojnë me vullnetin e tyre të lirë dhe të pranuar nga njëri-tjetri.

Trupi gjykues, pa synuar të zhbëjë ligjshmërinë e mandatarëkëtitimit, nisur nga rrethanat faktike dhe objektive të çështjes objekt vlerësimi, konkretisht, nga deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike për shtrirjen në kohë të pagimit të mandatarëkëtitimit datë 21.3.2009, parë edhe në harmoni me çdo të dhënë të dalë nga hetimi, krijon bindjen se subjekti ka kryer deklaratim të saktë lidhur me shlyerjen e pagesave të kësaj pasurie.

Në këtë vlerësim nga rillogaritjet e bëra nga Njësia e Shërbimit Ligjor rezultoi se subjekti rezulton në balancë pozitive dhe se ka pasur mundësi financiare të kryejë pagesat e kësteve të kësaj pasurie për vitin 2009, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

**1.49.ii** Në vijim, trupi gjykues, në lidhje me konstatimin tjetër se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 2.645.858 lekë, përgjatë viteve 2011 – 2013, për të shlyer huan, të shtonte kursimet vit pas viti, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, vlerëson të rillogarisë nëpërmjet Njësies së Shërbimit Ligjor, disa zëra të analizës financiare, sipas pretendimeve të subjektit, shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar prej tij.

Njësia e Shërbimit Ligjor përfshiu në analizën financiare të ardhurat e vitit kalendarik (1 janar – 31 dhjetor) që janë pagat e realizuara gjatë vitit sipas *statement*-it bankar, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen \*\*\*\*”, pasi subjekti depozitoi kontratën e shitjes. Ndërsa, shpenzimet e udhëtimit për qëllime pune, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, nuk u përfshinë në analizën financiare pasi u provua me dokumentacion mbështetës mbulimi i tyre nga organizatorët.

Trupi gjykues, lidhur me qëndrimin e subjektit për gjendjen *cash*, arsyeton duke mbajtur në konsideratë deklaratimet periodike vjetore të subjektit, deklaratimet gjatë hetimit administrativ, pretendimet e subjektit në prapësime, si dhe qëndrimin e Kolegjit, për aq sa orientohet në të. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me deklaratimet e kryera gjatë viteve 2009 – 2011. Për këtë periudhë, në deklaratimet e kursimeve në gjendjen *cash*, është përfshirë edhe gjendja likuiditet në banka në fund të çdo viti, deri në vitin 2011, duke qenë se nga analizimi dhe krahasimi i këtyre deklaratimeve, në të gjitha vitet, nuk u konstatua asnjë rast i vetëm në të cilin, gjendja likuiditet në bankë të tejkalonte gjendjen e deklaruar si *cash*. Ndërsa, për vitet pas kësaj periudhe, trupi gjykues i ka qëndruar me përpikëri deklaratimeve periodike të subjektit, ku shumën e deklaruar janë konsideruar si shtesa për sa kohë nuk është përcaktuar ndonjë destinacion i përdorimit të gjendjes *cash* apo në funksion të shlyerjes së

ndonjë detyrimi. Ndërsa, aty ku subjekti ka përcaktuar destinacionin e shpenzimit atëherë shuma është zbritur nga gjendja *cash*.

**1.50** Në përfundim të analizës, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen *cash*, shlyerjen e huas, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 dhe 2013, në shumën 1.785.365 lekë, duke u gjendur, për pasojë, përpara parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**1.51** Trupi gjykues rendit disa rrethana faktike lidhur me ndikimin që merr kjo balancë negative ndaj subjektit të rivlerësimit në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje:

**i.** ajo është e njëjtë me atë për të cilën edhe u aplikua masa disiplinore ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me vendimin përfundimtar të KPA-së.

**ii.** pasuria, në vlerësimin e provave dhe bindjen e brendshme, rezultoi e deklaruar me saktësi dhe e krijuar me burime të ligjshme.

**iii.** nga hetimi tërësor nuk u konstatuan të dhëna lidhur me pasuri të fshehura, deklarime të rreme apo ndonjë problematikë tjetër sa i përket këtij kriteri.

**iv.** për sa më sipër, rrethanat e mbetura nga kriteri i pasurisë janë vlerësuar në harmoni edhe me procesin e rivlerësimit për dy kriteret e tjera, për të cilat nuk rezultoi ndonjë problematikë.

**v.** aplikimi i së njëjtës masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit me atë të bashkëshortit të saj, në vështrim të konstatimeve të renditura më sipër, nuk do të ishte as proporcional dhe as objektiv dhe, për rrjedhojë, as i mjaftueshëm për ta vendosur subjektin në kushtet e aplikimit të ndonjë dispozite ligjore brenda nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**2. Automjet tip “Volkswagen \*\*\*”, viti i prodhimit 2003, me targa \*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 7.7.2015. Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

Burimi i krijimit: kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit nga paga dhe shpërblime të tjera në vite.

### **Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ**

**2.1** Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 me përshkrimin “automjet tip ‘Volkswagen \*\*\*, viti i prodhimit 2003, me targa \*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 7.7.2015. Vlera: 400.000 lekë.”

**2.2** Për këtë pasuri subjekti ka depozituar<sup>59</sup>: kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 7.7.2015, në vlerën 400.000 lekë, tip “Volkswagen \*\*\*”, viti i prodhimit 2003, me targa \*\*\*, palë shitëse K.N. dhe palë blerëse G. dhe Marinela Osmani.

**2.3** Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni me DPSHTRr-në, kjo e fundit ka informuar se nga verifikimet e bëra në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Mjeteve rezultoi se shtetasja Marinela K. Osmani ka të regjistruar automjetin me targa \*\*\*.

**2.4** Ky automjet është i regjistruar edhe në emër të bashkëshortit të subjektit G. A. O. .

**2.5** Në dokumentacionin e administruar nga kjo drejtori rezultoi se po kjo kontratë është depozituar edhe nga subjekti, ku palë shitëse është shtetasi K.N. (babai i subjektit) dhe palë blerëse G.O. dhe Marinela Osmani.

<sup>59</sup> Aneks nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

**2.6** Komisioni kreu analizën financiare vjetore dhe jo në momentin e blerjes së pasurisë (korrik 2015), sepse subjekti ka pasur një vit më parë gjendje *cash* të konsiderueshme. Komisioni, gjendjen *cash*, e ka trajtuar në pikën 3.

**2.7** Në konkluzion të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se nga analiza financiare e kryer dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 234.322 lekë, për të investuar në këtë pasuri, të shtonte kursimet, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit<sup>60</sup>.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni**

**2.8** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e saj në prapësime, ka shpjeguar:

*“i. Analiza financiare e vitit 2015 mbështetet mbi deklaratime, shpenzime, të dhëna, fakte dhe prova, identike me analizën financiare të zhvilluar për këtë vit në procedurën e rivlerësimit të bashkëshortit tim G.O. . Konkretisht, janë përdorur të njëjtat të dhëna që rrjedhin nga të njëjtat prova, që janë të pandryshueshme në kohë, të cilat janë: deklaratimet identike të subjekteve në deklaratat vjetore të pasurisë, si dhe gjatë procedurës së rivlerësimit; ekstraktet bankare të llogarive të pagës; deklaratime në lidhje me shpenzimet e arsimimit dhe transportit të vajzës Anda; të dhënat nga TIMS; kontratë blerje automjeti.*

*ii. Siç u argumentua më lart, shumë zëra të shpenzimeve të vendosura në tabelë janë të dyzuara në zërat e kategorive të klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit, në anketën e buxhetit të familjes për vitin 2015 të INSTAT-it (siç u argumentua më lart), ato shkojnë deri në të paktën 169,149 lekë, të cilat duhet t'i zbriten vlerës 897,104 lekë. Po kështu, vlera e shpenzimit për konsum sipas INSTAT-it është në masën 70,766 lekë x 12 muaj = 849,192 lekë, pra, 47,912 lekë më e ulët se ajo referuar sipas ILDKPKI-së në tabelë. Të gjitha këto të dhëna çojnë në vlera pozitive diferencën në tabelë.*

*iii. Diferenca negative midis të ardhurave me kursimet dhe shpenzimeve duhet vlerësuar në raport të drejtë midis tyre. Kështu, rezulton që vlera negative -82,979 lekë përbën 2.9% të të ardhurave në total prej 3,162,832 lekësh, e cila është një vlerë shumë e vogël dhe është në marzhin normal të llogaritjeve apo të devijimit nga fakti real.*

*iv. Analiza financiare është kryer duke marrë për bazë të dhënat dhe përfundimet në arsyetimin e vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi nr. 61, datë 2.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vitin 2015 nuk është kontestuar as nga Komisioneri Publik<sup>61</sup> dhe as gjatë gjykimit në KPA, ku është bërë sërish analiza financiare, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit G. O.<sup>62</sup>. Në këtë kontekst, çdo pretendim i ngritur në lidhje me këtë vit përbën gjë të gjykuar”.*

### **Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

**2.9** Trupi gjykues, për të mos rënë në përsëritje, pasi një pjesë e pretendimeve të pasqyruara më sipër janë pothuajse të njëjta për të gjithë periudhën e analizës financiare, ato të cilat janë marrë në konsideratë janë pasqyruar dhe arsyetuar në pasurinë nr.1 të këtij vendimi.

Për periudhën kur është krijuar kjo pasuri, subjekti ka pretenduar që shpenzimet e jetesës, të cilat nga viti 2014 përllogariten sipas Anketës së Buxhetit të Familjes, të zbriten nga analiza

<sup>60</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>61</sup> Komisioneri Publik në çdo rast kryen një analizë të pavarur ekonomike nga Komisioni.

<sup>62</sup> Kërkesa për të kryer një analizë të plotë financiare deri në deklaratën *Vetting*, është pranuar me vendim të ndërmjetëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.



financiare në zëra të shpenzimeve, të cilat publikohen dhe janë të përfshira njëkohësisht edhe në kategoritë e klasifikimit të konsumit individual.

Trupi gjykues, në ndryshim nga pretendimi i subjektit, nga hetimi në tërësi, ka konstatuar përpjekje të këtij të fundit për të rritur cilësinë e jetesës, në drejtim të udhëtimeve dhe pushimeve jashtë vendit, shkollimit të fëmijëve në shkollë/kolegj privat, ndryshimit të apartamentit, duke blerë një të tillë me sipërfaqe më të madhe dhe me çmim më të lartë dhe arredimin e tij në një vlerë të konsiderueshme. Në kushte të tilla, rrethanat e pasqyruara më sipër tregojnë se subjekti ka jetuar normalisht, madje duke kapërcyer nivelin e minimumit të shpenzimeve. Trupi gjykues, në këtë rast, sigurisht, nuk mundet të përcaktojë një vlerë të posaçme për shpenzimet e tij jetike, por vlerëson se për këto shpenzime, referuar INSTAT-it, duhet të merren në konsideratë vlerat që u përkasin shpenzimeve mesatare mujore për konsum për familje me 4 anëtarë.

**2.10** Në përfundim, pas rilloaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të arsyetuara më sipër dhe duke mos marrë në konsideratë pretendimin lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti rezultoi në balancë pozitive për vitin 2015.

**3. Shuma 400.000 lekë cash**, jashtë sistemit bankar, për nevoja të familjes.

Burimi i krijimit: kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit nga paga dhe shpërblime të tjera në vite. Pjesa takuese: 50%.

**3.1** Komisioni ka përlllogaritur gjendjen e likuiditeteve *cash* (jashtë sistemit bankar) të subjektit duke u bazuar në deklaratat periodike. Subjekti deklaroi për herë të parë kursime *cash* në vitin 2008 dhe, më pas, çdo vit deri në deklaratën *Vetting*.

**3.2** Gjatë hetimit<sup>63</sup> subjekti ka sqaruar se deklaratat e kryera në vite në lidhje me kursimet *cash* për vitet 2009 – 2013, nuk kanë qenë shtesa, pasi atyre duhet t'u zbriten shumat e përdorura për likuidimin e kësteve të apartamentit, si edhe shpenzimet apo shumat për kthimet e huas, ndërsa për vitet 2014 – 2016, që nuk ka pasur më detyrime financiare për të shlyer, shumat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore përputhen me shtesën *cash* për këto vite. Subjekti është shprehur se kursimi ishte konceptuar dhe deklaruar si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve për jetesë. Kursimet të deklaruar nuk i janë zbritur detyrimet financiare dhe, për pasojë, nuk është deklaruar si pakësim.

**3.3** Komisioni vlerësoi që analiza financiare e subjektit të rivlerësimit të kryej me gjendjen *cash* të akumuluar sipas përlllogaritjeve të Komisionit, që përputhet me deklaratat periodike vjetore dhe jo me atë të pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

Gjatë hetimit ka rezultuar se përgjatë janarit të vitit 2017 subjekti ka kryer veprimet si vijojnë:

- ka derdhur në llogarinë bankare në “Credins Bank” shumën prej 22.100 euro nga kursimet *cash* nëpërmjet dy transaksioneve, përkatësisht 2.100 euro, datë 13.1.2017 dhe 20.000 euro, datë 16.1.2017;
- ka kryer shpenzimet e arredimit<sup>64</sup> të apartamentit me sip. 96 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.800.000 lekë.

**3.4** Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për muajin janar deri më 25.1.2017, kur është dorëzuar deklarata *Vetting* dhe është deklaruar gjendja *cash* prej 400.000 lekësh, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare përgjatë muajit janar 2017.

<sup>63</sup> Pyetësori nr. 2, datë 8.9.2020, paraqitur edhe në formë tabelare.

<sup>64</sup> Deklaruar në pyetësorin standard, datë 4.12.2019.

**4. Llogaria bankare nr. \*\*\*, në euro**, në “Credins Bank” sh.a., deri më 16.1.2017. Vlera: 20.060 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit nga paga dhe shpërblime të tjera në vite.

**4.1** Nga korrespondenca e mbajtur, “Credins Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, konfirmon llogari me gjendje në vlerën 20.060 euro, datë 25.1.2017.

**4.2** Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari bankare.

**5. Llogaria bankare nr. \*\*\*, hapur në “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., deri në datën 14.1.2017.** Vlera: 353.24 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kompensim nga një udhëtim i bashkëshortit të subjektit për një trajnim në programin e organizuar nga International Finance Corporation” (IFC), “\*\*\*”, në Malajzi.

**5.1** Nga korrespondenca e mbajtur, “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2020, konfirmon llogari në emër të znj. Marinela Osmani me gjendje në vlerën 353.24 euro, në datën 25.1.2017.

**5.2** Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” për gjendjen e llogarisë në datën 25.1.2017, por ka një pasaktësi në emrin e llogarimbajtësit, pasi kjo llogari është në emër të subjektit dhe jo në emër të bashkëshortit.

**6. Lidhur me analizën financiare për vitet 2014 dhe 2016**, subjekti ka parashtruar qëndrimin e tij, i cili është pasqyruar në pasuritë e mësipërme. Trupi gjykues, për të mos ripërsëritur pretendimet e subjektit, pasi janë të njëjta për të gjithë periudhën e analizës financiare dhe për to ka arsyetuar në pasuritë e analizuara në këtë vendim, konkludon se nga rillogaritjet e kryera nuk rezultojnë problematika, që mund të ndikojnë në vlerësimin tërësor të kësaj vendimmarrjeje.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës, të deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani.

Komisioni<sup>65</sup> ka kërkuar përditësimin e raportit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, në përgjigje të së cilës DSIK-ja ka konfirmuar se nga verifikimet nuk rezultojnë të dhëna të tjera shtesë lidhur me këtë subjekt.

Nga hetimi i Komisionit nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

<sup>65</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2020.

## C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Në lidhje me këtë komponent, raporti<sup>66</sup> është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1.1 Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) *aftësitë profesionale;*
- b) *aftësitë organizative;*
- c) *etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe*
- ç) *aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

1.2 Analiza e gjetjeve në raport i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLD. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën II të këtij raporti me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

1.3 Në lidhje me njohuritë ligjore, subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor. Në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Ajo ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është e aftë të identifikojë rastet, kur zbatohet ligji specifik apo ligji më i hershëm në kohë. Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale, ku bien në sy e drejta e pronësisë, afatet e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, e drejta e njohjes pronar, shpërblimi i dëmit, vërtetimi i faktit juridik të marrëdhënieve të punës, si dhe likuidimi i shoqërive tregtare. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

1.4 Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

1.4.1 Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit te thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetimin e tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

<sup>66</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, administruar në dosjen e vlerësimit profesional.

**1.4.2** Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendimi nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Gjithashtu, në të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

**1.5** Në lidhje me aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, konstatohet se gjyqtarja Marinela Osmani ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal dhe i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsytimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

**1.6** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit, gjyqtarja identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre, si dhe zhvillon, sipas ligjit, procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, te pretendimet fillestare të palëve, prapësimet e tyre, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar i palëve e deri te shpallja e vendimit.

**1.7** Në lidhje me aftësinë për të administruar dosjet, nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile ose procedurale penale. Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e përfaqësimit, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura, ndërsa edhe në dosjen penale gjendet i administruar vendimi i gjyqtarës për caktimin e seancës gjyqësore. Dosjet janë të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët dhe më pas ato të krijuara nga gjykata. Aktet janë administruar në referencë të rregullave procedurale civile apo penale dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

**1.8** Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Marinela Osmani. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

## **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

**1.9** Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt, ka konstatuar si vijon:

**a.** Për dokumentin (e llojit “vendim”) <sup>167</sup>, <sup>268</sup> dhe <sup>369</sup> nuk pasqyrohen të dhëna nëse është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse.

<sup>67</sup> Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 10.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket Paditësve N. F., etj, me të paditur shoqëria “V. P.-A.” sh.p.k., etj., person i tretë ZVRPP-ja Tiranë, me objekt “pavlefshmëri e kontratës së hipotekimit, etj.”.

<sup>68</sup> Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 16.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket kërkuetit: shoqëria “F. B.& C.C.” sh.p.k., me person të tretë shoqëria përmbarimore “\*\*\*\*” sh.p.k., etj.

<sup>69</sup> Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket paditësve V.H., etj., me të paditur A.S. dhe A.B. .

**b.** Në asnjërin prej vendimeve që përfaqësojnë tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti nuk rezulton e pasqyruar data e regjistrimit të çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit, nëse është brenda apo jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit<sup>70</sup>.

**b.i.** Në kushte të tilla, Komisioni i kërkoi subjektit: (i) të depozitojë dokumentacionin mbi statusin aktual të tri çështjeve të sipërpërmendura, duke u përqendruar tek ushtrimi i të drejtës ankimore nga palët (nëse ajo është ushtruar) dhe vijueshmëria e mëtejshme e procesit gjyqësor; (ii) të qartësonte lidhur me datën e regjistrimit të secilës prej çështjeve, duke depozituar edhe dokumentacionin mbështetës.

Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, lidhur me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 10.3.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse: me paditës N. F. dhe L. Q., të paditur shoqëria “V. P.-A.” sh.p.k., shoqëria “Alpha Bank Albania” sh.a., shoqëria “E.L.” sh.p.k. dhe person i tretë: Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, ka shpjeguar se:

Me këtë vendim është vendosur: “1. *Pranimi i kërkesëpadisë ...*; 2. *Detyrimi i palës së paditur, shoqëria ‘V. P.-A.’ sh.p.k., të njohë pronarë paditësit ... për pasurinë e paluajtshme...*”.

Çështja është regjistruar me nr\*\*\* akti, datë 6.11.2013, dhe deri në dhënien e vendimit janë zhvilluar 3 seanca përgatitore dhe 5 seanca gjyqësore. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim, mbi bazën e të cilit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.7.2015, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 10.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*”. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe dosja ndodhet aktualisht në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës: shkresën kthim-përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 10.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe të dhënat *online* nga adresat e gjykatës, [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al) dhe [www.gjykataelartë.gov.al](http://www.gjykataelartë.gov.al).

Në lidhje me vendimin e dytë me nr. \*\*\*, datë 16.6.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: kërkues shoqëria “F. B. & C.C.” sh.p.k., person i tretë shoqëria përmbarimore “\*\*\*” sh.p.k., me të cilin është vendosur: “*Pranimi i pjesshëm i kërkesës ..*”, subjekti ka shpjeguar se çështja është regjistruar me nr. \*\*\* akti, datë 20.4.2015, dhe deri në dhënien e vendimit janë zhvilluar një seancë përgatitore dhe pesë seanca gjyqësore. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim, mbi bazën e të cilit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.12.2016, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*”. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe dosja ndodhet aktualisht në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, shkresën kthim-përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, dhe kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe të dhënat *online* nga adresat e sipërpërmendura të gjykatës.

Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, që u përket palëve ndërgjyqëse, paditës I. H., etj., dhe të paditur A.S. etj., subjekti ka shpjeguar se: “*Me këtë vendim, është vendosur: ‘Rrëzimi i padisë së palëve paditëse, si i pabazuar në ligj dhe në prova. Heqja e masës së sigurimit të padisë të vendosur në vendimin nr. \*\*\* akti, datë 5.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Garancia e dhënë... i kthehet palës paditëse, në rast se palët e paditura ....’*. Çështja është regjistruar me nr. \*\*\*akti, datë 18.1.2016<sup>71</sup> dhe deri në dhënien e vendimit janë zhvilluar nga ana ime 1 seancë përgatitore dhe 3 seanca gjyqësore. Kundër këtij vendimi është

<sup>70</sup> Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

<sup>71</sup> Çështja ka qenë më parë për shqyrtim pranë gjyqtarës T.H. .

*ushtruar ankim, mbi bazë e të cilit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe dosja aktualisht ndodhet pranë Gjykatës së Lartë dhe nuk ka datë të planifikuar për shqyrtimin e saj”.*

Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe të dhënat *online* nga adresat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Lartë.

### **Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

**1.10** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, ka konstatuar se, për sa i përket statusit të tri vendimeve të përzgjedhura, secili prej tyre është ankimuar, pra është ushtruar e drejta e ankimit të palëve dhe, po ashtu, secila prej tyre administrohet në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e palëve në proces.

**1.11** Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, nga verifikimi i dokumenteve të depozituara u konstatua se të tria çështjet janë gjykuar brenda afatit 6-muaj, në përputhje me Sistemin e Vlerësimit të miratuar nga ish-KLD-ja, me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, germa “e”, pika 5, sipas të cilit afati maksimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile në shkallën e parë është 6 muaj.

**1.12** Trupi gjykues, lidhur me konstatimet e mësipërme, nisur nga komponentët vlerësues të kriterit profesional, parashikuar në ligjin nr. 96/2016, gërshetuar me ligjin nr. 84/2016, po për këtë kriter, nuk evidenton ndonjë problematikë e cila do të ndikonte në vlerësimin e kriterit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

**c.** Po në vijim të vlerësimit të këtij kriteri, nga analiza e tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, Komisionit i rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Marinela Osmani ka qenë në intervale kohore të ndryshme.

Në tërësi konstatohet se në vendimet gjyqësore përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**ç.** Në përgjigje të kërkesës<sup>72</sup> së Komisionit, sikurse është pasqyruar edhe në raportin e vlerësimit profesional, Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>73</sup> ka konfirmuar për gjyqtaren Marinela Osmani se nuk rezulton të jetë propozuar apo të ketë ardhur në ish-KLD ndonjë kërkesë për masë disiplinore, nga Ministria e Drejtësisë.

### **Në lidhje me denoncimet e depozituara në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016**

Në Komision janë depozituar në tërësi 14<sup>74</sup> denoncime. Një prej denoncuesve ka depozituar në mënyrë të përsëritur denoncimin<sup>75</sup> i cili referon të njëjtin objekt ankimi dhe pretendon të njëjtat shkelje ndaj subjektit të rivlerësimit.

<sup>72</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019.

<sup>73</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 7.1.2020.

<sup>74</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2017; nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2018; nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2019; nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018; nr. \*\*\*prot., datë 15.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020; nr. \*\*\*prot., datë 11.7.2019; nr. \*\*\*prot., datë 29.6.2018.

<sup>75</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019, i shtetasit T. Sh. .

Komisioni, lidhur me 4<sup>76</sup> denoncimet, pas studimit dhe verifikimit të dokumentacionit provues, i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi disa paqartësi të konstatuara. Ndërsa, lidhur me denoncimet e tjera, Komisioni përgjithësisht ka vërejtur se nga denoncuesit nuk jepen *indicie* që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit ose trajtohet kryesisht themeli i çështjeve gjyqësore, çka nënkupton se nuk gjendet përpara shkeljeve të natyrës procedurale, të cilat mund t'i atribuohen subjektit në raport me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit të posaçëm nr. 96/2016.

## **1. Denoncimi<sup>77</sup> i shtetasit H. H.**

**1.1** Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë me cilësinë e anëtares/kryesueses. Gjithashtu, denoncuesi ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor, fakt të cilin pretendon se e provon edhe me përgjigjen e KLD-së. Në pretendimet e tij sqaron se ka kërkuar riekspertim (pasi për ekspertimin e parë pretendon se ka qenë i rremë), kërkesë e cila sipas tij nuk i është pranuar.

Denoncuesi ka depozituar vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket palës paditëse H. H., etj., palë e paditur kompania “\*\*\*” sh. a., me objekt “detyrim i të paditurit për pagimin e dëmit të plotë pasuror dhe jo pasuror që i është shkaktuar paditësve si rezultat i aksidentit, me pasojë humbjen e jetës së dy shtetasve dhe dëmtimin e një shtetaseje”. Nga verifikimi i vendimit rezulton se ndaj tij është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi” të vendimit të shkallës së parë.

Nga verifikimi i përgjigjes së dhënë nga KLD-ja në datën 25.8.2017, konstatohet se ky institucion ka konkluduar se ka vend për verifikimin e ankesës për zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe për vonesën e treguar në dërgimin e dosjes në Gjykatën e Apelit Tiranë. Konstatohet se përgjigja është adresuar mbi ankesën nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, të shtetasit N. H. . Vërehet se ndërsa ankesa është depozituar pas 2 muajve nga dhënia e vendimit të shkallës së parë dhe 7 muajve përpara dhënies së vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, përgjigja e KLD-së, së bashku me konstatimet përkatëse, është dhënë pas 8 muajve nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në kushtet kur nga verifikimi i vendimit të shkallës së parë nuk rezulton të identifikohet data e regjistrimit të padisë por vetëm numri i aktit të çështjes, nuk mundësohet verifikimi i zgjatjes së procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit në mars të vitit 2016.

Po ashtu, denoncuesi nuk qartëson nëse ndaj vendimit të apelit është ushtuar e drejta e rekursit.

**1.2** Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime: (i) duke u përqendruar te kohëzgjatja e zhvillimit të procesit gjyqësor prej regjistrimit të padisë dhe deri në dhënien e vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, ku ka qenë në cilësinë e anëtares/kryesueses; (ii) të qartësojë nëse nga denoncuesi është ushtruar rekurs, duke sqaruar mbi statusin aktual të kësaj çështjeje gjyqësore; si dhe (iii) të qartësojë nëse janë ndërmarrë veprime të mëtejshme nga organi i KLD-së, aktualisht KLGJ-ja, pas përgjigjes së dhënë mbi ankesën e shtetasit H. H. . Njëkohësisht i është kërkuar të depozitojë dokumentacionin mbështetës mbi deklaratimet e saj.

**1.3** Në lidhje me këtë denoncim, subjekti fillimisht ka qartësuar statusin gjyqësor të çështjes objekt gjykimi, duke cilësuar se mbi ankimin e ushtruar ndaj vendimit të dhënë prej saj me nr.

<sup>76</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018; nr.\*\*\* prot., datë 26.6.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019 i shtetasit T. Sh.; nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019.

<sup>77</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018.

\*\*\*, datë 17.3.2016, është vendosur “Lënia në fuqi” dhe është ushtruar rekurs, ku seanca e fundit ka qenë e planifikuar për në datën 5.7.2018, ora 09:15:00.

Subjekti ka bërë një përshkrim të ankimeve të depozituara për këtë rast gjyqësor nga pala paditëse në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (aktualisht KLGJ) dhe në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Gjithashtu ka qartësuar edhe lidhur me hapat e ndërmarrë nga KLD-ja lidhur me pretendimin e ankuesit për zvarritje të procesit nga subjekti, për të cilin ka kryer verifikimet përkatëse, ku dhe është konkluduar se gjykimi i çështjes tej afatit dhe shkaqet që kanë sjellë tejkalim të tyre do të evidentoheshin vetëm si e dhënë statistikore për vlerësimin profesional dhe etik. Subjekti ka synuar të argumentojë lidhur me afatin e tejkaluar të gjykimit për 1 vit, 1 muaj dhe 5 ditë. Po ashtu, ka saktësuar se janë zhvilluar 22 seanca përgatitore dhe gjyqësore. Gjithashtu subjekti, në referim të bazueshmërisë ligjore, konkretisht të vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, interpretuar në raport me vendimin nr. 5, datë 12.12.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese, është shprehur se në këtë rast duhet të mbahet në konsideratë kompleksiteti i çështjes, jo vetëm në aspektin e hetimit gjyqësor të zhvilluar mbi të gjitha pretendimet e palëve paditëse, por dhe në aspektin njerëzor, duke respektuar dhe dhimbjen për humbjen në aksident të dy vajzave të tyre. Subjekti e ka lidhur kohëzgjatjen edhe me faktin se dosja ka administruar dy akte ekspertimi, atë mjekoligjor, por edhe aktin lidhur me dëmin e kërkuar dhe që për to është marrë kohë për t’u dëgjuar dhe debatuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Subjekti gjithashtu ka renditur të gjithë shtyrjet e seancave të cilat kanë ardhur për shkak të vetë palës paditëse, përfshirë depozitimin e provave të reja, kohën e kërkuar nga palët për njohjen me to, por edhe shtyrjen për rregullimin e të metave të aktit të përfaqësimit, për sa i përkiste paditësit Xh. H., përcaktimit të vlerës së objektit të padisë dhe pagimit të taksës gjyqësore, bazuar në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti ka sqaruar se asnjë seancë nuk është shtyrë për shkak të saj. Ajo ka shpjeguar edhe lidhur me depozitimin e vendimit të arsyetuar, diktuar nga kompleksiteti i çështjes.

Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, shkresën kthim-përgjigje me nr. \*\*\*prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kopje të vendimit nr. \*\*\* , datë 17.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; fletën e regjistrimit të numërtimit dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar; ankesën nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2016, të paditëses N. H.; shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2017, të Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë; shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2018, të Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë; kopje të faqes së parë të dosjes që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 17.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kopje të kërkesëpadisë, vendimin për caktimin e veprimeve përgatitore datë 16.6.2014; procesverbalet e seancave; vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 17.3.2016, bashkë me urdhrin e ekzekutimit; si dhe të dhënat *online* nga adresa e Gjykatës së Lartë.

**1.4** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të depozituara, konkludon se çështja mund të vlerësohet si komplekse për shkak të objektit të kërkit të padisë si pasojë e një aksidenti me humbje jetësh, vlerës së kërkuar për shkak të aksidentit, ekspertizës së kryer e cila merr kohën e saj për të ndjekur procedurën që me thirrjen e ekspertit, detyrat e lëna, shprehjen e dakordësisë ose jo të palëve, të drejtat e këtyre të fundit për t’u njohur dhe bërë oponencën, etj.

Për sa i përket anës procedurale, rezultoi se çështja është regjistruar në datën 10.6.2014 dhe ka përfunduar më 17.3.2016, pra, konstatohet se ajo ka tejkaluar afatet e gjykimit (6 muaj), pasi ka zgjatur 1 vit, 9 muaj dhe 7 ditë. Konkretisht është vërejtur se në dy raste është zgjatur afati 30-ditor i caktimit të seancës. Seanca e parë përgatitore ka zgjatur 2 muaj e 24 ditë dhe seanca gjyqësore ka zgjatur 2 muaj e gjashtë ditë, nga data 16.6.2014 deri më 10.9.2014.



Lidhur me statusin aktual të çështjes u vërejt se ajo është rekursuar dhe aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.

Pra, parë në aspektin procedural, konstatohet se çështja është gjykuar në tejkallim të afateve të lejuara, por sigurisht duke e vlerësuar në kuadër të objektit të padisë, palëve ndërgjyqëse, provave të shumta të administruara, domosdoshmërisë së njohjes me to, pra, në tërësi duke çmuar kompleksitetin e saj nga njëra anë dhe zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për palët, nga ana tjetër, trupi gjykues konkludon se proporcionalisht përfundimi tej afatit të kësaj çështjeje gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit është mjaftueshmërisht i vlerësuar nga KLD-ja (aktualisht KLGJ), duke e përfshirë në të dhënat statistikore të vonesave në proceset gjyqësore të përfunduara, por që në logjikën e trupit gjykues çmohet si një rast i vetëm i cili nuk mund të ndikojë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit.

## **2. Denoncimi<sup>78</sup> i shtetasit A. C.**

**2.1** Denoncuesi ankohet për moszbardhje të vendimit brenda afatit me pasojë humbjen e të drejtës së ushtrimit të ankimit.

Denoncuesi ka depozituar:

- vendimin nr. \*\*\* akti, datë 13.10.2015, “Për lëshim urdhri ekzekutimi” të dhënë nga një tjetër subjekt rivlerësimi;
- vendimin nr. \*\*\*, datë 10.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me palë paditëse denoncuesin, të paditur shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., “Raiffeisen Bank”, etj., me objekt “kundërshtim veprimesh përmbartimore”; si dhe
- dokumente të tjera që lidhen me themelin e çështjes objekt gjykimi.

Në analizë të vendimit rezulton se denoncuesi ka qenë prezent në shpalljen e tij dhe se vendimi është shprehur edhe mbi të drejtën e ushtrimit të ankimit nga palët ndërgjyqëse. Sa i përket arsytimit dhe dorëzimit të vendimit jashtë afatit të parashikuar në ligj, konkretisht, sipas nenit 308 të Kodit Procedurës Civile, denoncuesi nuk ka depozituar ndonjë dokument mbështetës.

**2.2** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimin e denoncuesit për mosarsyetim/moszbardhje të vendimit në kohë, të depozitohet dokumentacionin mbështetës mbi shpjegimet e saj, duke përfshirë fletën e regjistrimit të numërtimit të vendimit të dhënë, si dhe dokumentin provues ku konfirmohet dorëzimi i vendimit të arsyetuar.

**2.3** Subjekti, në parashtrimet e saj, ka qartësuar lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, duke argumentuar se fillimisht çështja gjyqësore është caktuar pranë një tjetër subjekti rivlerësimi, i cili për shkak të emërimit në një gjykatë më të lartë ka sjellë si pasojë rishortimin e saj. Pra, subjekti është shprehur se: *“Me shortin e datës 21.11.2016, çështja ka kaluar pranë meje për shqyrtim<sup>79</sup> dhe me vendimin e ndërmjetëm datë 23.11.2016, ‘Për caktimin e seancës së veprimeve përgatitore’<sup>80</sup>, është caktuar seanca e parë përgatitore në datën 19.1.2017, ora 11:00, duke filluar shqyrtimi i çështjes nga fillimi, në kushtet kur është ndryshuar tërësisht trupi gjykues”*.

Subjekti ka qartësuar lidhur me domosdoshmërinë e kryerjes së akteve të ekspertimit, për shkak të interesave dhe të penaliteteve të rrjedhura nga kontrata e kredisë bankare datë 6.11.2017, si dhe debatit midis palëve. Gjithashtu, ka qartësuar se në seancën e datës 10.7.2017, kur është

<sup>78</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018.

<sup>79</sup> Marrë në dorëzim fizikisht në datën 23.11.2016.

<sup>80</sup> Në bazë të nenit të Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes parashikohej se: *“... kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues, çështja fillon nga fillimi”*.

zhvilluar seanca e fundit gjyqësore, menjëherë pas dhënies së pretendimeve përfundimtare, është dhënë vendimi i gjykatës.

Subjekti është shprehur se: *“Seanca e kësaj date, bashkë me dispozitivin e vendimit, është hedhur në sistem nga sekretarja gjyqësore në datën 10.7.2017, ora 14:16<sup>81</sup>. Të dhënat e sistemit dalin në faqen online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, www.gjykatatirana.gov.al. Të gjitha palët ndërgjyqëse pajisen me një kod hyrës dhe marrin çdo të dhënë mbi gjendjen e gjykimit, vendimmarrjet dhe statusin e çështjes.*

*Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar në kryesekretari në datën 26.7.2017, 15 ditë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit (10.7.2017 - 26.7.2017).*

*Bazuar në të dhënat e rezultateve të raportit të hetimit administrativ konstatohet se ndaj përfaqësuesit të palës paditëse A.C., z. N. T., nga ana ime është dhënë vendimi nr. \*\*\*, datë 7.11.2016, i cili është lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit Tiranë, me vendimin nr.\*\*\* , datë 10.5.2017. Në këtë proces gjyqësor z. T. ka qenë në cilësinë e palës së paditur. Ndaj meje për dhënien e këtij vendimi pala paditëse ka paraqitur një denoncim<sup>82</sup>, ku referohen të dhëna jo të vërteta, të cilat janë konstatuar edhe nga Komisioni”.*

Subjekti i ka konsideruar të padrejta dhe të paprovuara pretendimet e denoncuesit, për arsye se: *“Nga fleta e regjistrimit të numërimit të vendimit dhe të dhënat nga sistemi i administrimit rezulton se janë hedhur të dhënat e plota të dispozitivit të vendimit, të dhënat e sistemit dalin në faqen online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, www.gjykatatirana.gov.al dhe kanë qenë të aksesueshme nga pala paditëse. Të gjitha palët ndërgjyqëse pajisen me një kod hyrës dhe marrin çdo të dhënë mbi gjendjen e gjykimit, vendimmarrjet dhe statusin e çështjes; pala paditëse ka qenë prezent në shpalljen e vendimit dhe ka ardhur në dijeni të shkaqeve të vendimit dhe afatit të ankimit, si dhe të momentit në të cilin fillon të ecë ky afat. Në asnjë rast afati i ankimit nuk lidhet me komunikimin fizikisht të kopjes së vendimit; pretendimet e tij ngelen në nivel deklarativ në kushtet kur ai nuk provon të ketë paraqitur ndonjë ankim, i cili është konsideruar i paplotë nga zyra e regjistrimit të ankimeve, duke u kaluar nga ajo për disponim ankimi. Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë provohet se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë kërkesë civile më objekt ‘disponim ankimi ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 10.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë’. Po kështu, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë provohet se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë kërkesë civile më objekt ‘rivendosje në afat të ankimit ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 10.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë’, meqë pala pretendon se e ka humbur afatin e ankimit; rezulton e provuar që pala paditëse ka vijuar me paraqitjen e padive të reja në gjykatë për të njëjtën mosmarrëveshje dhe aktualisht ka ushtruar ankim ndaj vendimit, i cili ka zgjidhur në themel pretendimet e tij mbi kredinë e vitit 2017, të cilat në mënyrë të pabazuar në ligj pretendonte t’i zgjidhte në kuadër të gjykimit të posaçëm me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore, etj.*

*Për sa i përket dorëzimit të dosjes gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, rezulton se depozitimi është bërë në kryesekretari në datën 26.7.2017, 15 ditë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit (10.7.2017 - 26.7.2017), për shkak të ngarkesës ditore në seanca gjyqësore, veprime paraprake, shpallje dhe arsyetime vendimesh, ishte objektivisht i pamundur respektimi i afatit 10-ditor të dorëzimit të dosjeve, afat i cili i referohej një ngarkese shumë më të ulët se ajo e vitit 2016 e në vijim”.*

Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës: shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kopjen e disa akteve marrë nga dosja me nr.

<sup>81</sup> Provuar me printimin nga sistemi i gjurmimit të IT-së.

<sup>82</sup> Denoncimi 5 – me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 28.3.2019.

\*\*\* vendimi, datë 10.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; fletën e regjistrimit të numërtimit dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar; kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 8.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të dhënat *online* nga adresa e Gjykatës së Lartë për çështjen me nr. \*\*\* vendimi, datë 8.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. \*\*\*, datë 24.10.2019; shkresën nr. \*\*\*prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me printim nga sistemi; kopjen e librit të dorëzimit të sekretares gjyqësore për periudhën 3.7.2017 – 27.7.2017.

**2.4** Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, konstaton se subjekti ka dhënë argumente bindës lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor, veprimet procedurale, por edhe themelore të kryera, si domosdoshmëria e kryerjes së aktit të ekspertimit kontabël, diktuar edhe nga vetë objekti i padisë. Pra, nëse kjo logjikë zë vend në kohëzgjatjen e gjykimit për 8 muaj, pretendimi i subjektit se palët për të ushtruar ankim mund të mjaftohen me të dhënat e dispozitivit të vendimit, të hedhura në sistem dhe sigurisht të aksesuara prej tyre nëpërmjet kodit hyrës, relativisht nuk qëndron. Kjo për faktin se ligjvënësi në parashikimet e tij ka pasur parasysh një afat përcaktues për arsyetimin e vendimit me qëllim për t'i lënë kohë të mjaftueshme palëve që të mund të njihet me argumentet e pasqyruar në pjesën arsyetuese të vendimit për të ushtruar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë ankimin. Vërtet dispozitivi i vendimit është ekzekutimi i tij, por ankimi ndaj vendimit ka lidhje ngushtësisht me detajet e përdorura në vendimmarrje. Megjithëkëtë, trupi gjykues e vlerëson rastin proporcionalisht, pasi pretendimi i denoncuesit ka qenë thjesht dhe vetëm me qëllim identifikimin e arsyesimit të vonuar të vendimit të arsyetuar dhe depozituar vetëm pak ditë përtej afatit 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, por që në mënyrë të drejtpërdrejtë duket se për denoncuesin nuk ka sjellë asnjë pasojë, për sa kohë ky i fundit rezulton të mos ketë ushtruar ankim, që në mënyrë indirekte lë të kuptohet se është pajtuar me vendimmarrjen. Trupi gjykues argumenton nën këtë logjikë, për më tepër kur konstaton se denoncuesi ka qenë prezent në shpalljen e vendimit dhe se nuk ka vijuar ankimin e tij nën objektin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit. Në argumentet e pasqyruara më sipër, por edhe duke mbajtur në vëmendje volumin e çështjeve për gjykim, kompleksitetin e tyre rast pas rasti, trupi gjykues çmon se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk identifikohen problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e saj profesional.

### **3. Denoncim<sup>83</sup> anonim**

**3.1** Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të njëanshme të subjektit të rivlerësimit, për mosmarrje të provave gjatë shqyrtimit të procesit gjyqësor dhe për favorizim të palës kundërshtare, duke i humbur të drejtën e pronësisë. Në vijim ankohet për shpërdorim detyre dhe interpretim të gabuar të ligjit në vendimmarrjen e dhënë. Denoncuesi kërkon të verifikohet çështja. Ndër të tjera, ankohet se: (i) gjyqtarja ka vijuar të marrë dhe administrojë prova edhe pas caktimit të seancës gjyqësore; (ii) ka shkelur nenin 171/a të Kodit të Procedurës Civile, ku citohet se: *“Gjyqtari, pasi sigurohet për kryerjen e të gjithë veprimeve përgatitore, menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Afati për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë”*; (iii) vendimi është shpallur i paarsyetuar dhe nuk është dorëzuar brenda afatit 7-ditor.

Denoncuesi ka cituar se ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ka depozituar vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 13.4.2017, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ankimin e ushtruar ndaj tij.

Sipas vendimit pasqyrohet se çështja gjyqësore ka pasur si objekt lirim të një prone. Gjithashtu procesi civil është karakterizuar nga padi dhe kundërpadi të palëve ndërgjyqëse.

<sup>83</sup> Nr\*\*\*prot., datë 26.6.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019, i shtetasit T .Sh. .

Nisur nga fakti se çështja vijon shqyrtimin e saj në gjykatat e shkallëve më të larta, është e drejtë e këtyre të fundit të shprehen mbi ligjërimin e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit.

**3.2** Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime për sa i përket pretendimeve të denoncuesit, të renditura më sipër si (i), (ii) dhe (iii) në pikën 3, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

**3.3** Subjekti, në parashtrimet e saj lidhur me këtë denoncim, fillimisht ka sqaruar mbi statusin aktual të saj. Më konkretisht, ka pasqyruar faktin se çështja është ankimuar dhe se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.11.2019, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe nuk ka planifikim për ndonjë seancë gjyqësore. Po ashtu, subjekti ka sqaruar se *çështja është gjykuar në vijim të dispozitave procedurale përpara hyrjes në fuqi të amendamenteve të miratuara me ligjin nr. 38/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”* dhe në këtë kontekst është shprehur përfshirë edhe konceptin e urdhërimit të caktimit të seancës gjyqësore. Subjekti ka sqaruar se denoncuesi në ankimin e tij i është referuar ndryshimeve ligjore të cilat nuk konsiderohen në këtë rast, ndërsa ecuria e procesit i është referuar dispozitave përpara ndryshimit për shkak se padia është depozituar përpara hyrjes në fuqi të tyre. Subjekti ka qartësuar edhe lidhur me marrjen e provave gjatë procesit, duke e lidhur edhe këtë procedurë me zhvillimin e procesit, referuar funksionimit të legjislacionit procedural në kohën e depozitimit të padisë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar edhe lidhur me arsyetimin e vendimit brenda 14 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së tij.

Në rastin konkret, trupi gjykues, referuar dispozitave procedurale, konstaton se çështja është gjykuar në bazë të parashikimeve ligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë, pra, nga subjekti janë ezauruar të gjitha pretendimet e palëve mbi mosmarrëveshjen, fakt i cili provohet me lënien në fuqi të vendimit nga gjykata më e lartë. Kjo gjykatë nuk ka konstatuar asnjë mangësi në aspektin e hetimit gjyqësor, gjatë të cilit janë marrë të gjitha provat e nevojshme për kryerjen e aktekspertimit, si dhe provat për shkak të paraqitjes së kundërpadisë, rregullimit të ndërgjyqësisë dhe sqarimit të rrethanave të faktit në funksion të zgjidhjes së drejtë të mosmarrëveshjes.

Subjekti e ka trajtuar çështjen komplekse me padi dhe kundërpadi, gjykime të mëparshme të zhvilluara nga palët dhe detyra të lëna për zgjidhje nga gjykatat më të larta. Subjekti është shprehur se: *“Respektimi i afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit për shkak të ngarkesës ishte një pamundësi objektive nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të ngarkesës dhe të kompleksitetit të përgjithshëm të çështjeve që gjykohen në këtë gjykatë. Gjatë periudhës 2017 dhe në vijim unë kam qenë pjesë e seksionit tregtar të Dhomës Civile, i cili karakterizohej nga një shkallë më e lartë vështirësie çështjesh në kompetencë të tij, ku në veçanti dalloheshin çështjet e falimentimit. Vetëm gjatë periudhës 6.4.2017 – 28.4.2017 janë dorëzuar 57 vendime të arsyetuara dhe shpallur 55 vendime gjyqësore, pra gjithsej 112 vendime, të cilat janë përfunduar gjithmonë jashtë orarit zyrtar”*.

Subjekti ka depozituar: (i) shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 13.4.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) fletën e regjistrit të numërtimit dhe dorëzimit të vendimit të arsyetuar; (iv) të dhënat *online* nga adresa e Gjykatës së Lartë; (v) kopjen e librit të dorëzimit të sekretares gjyqësore për periudhën 6.4.2017 – 28.4.2017; si dhe (vi) listën e çështjeve nga data 6.4.2017 – më 28.4.2017, printim nga sistemi.

**3.4** Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve ligjore të subjektit lidhur me veprimet procedurale të kryera në këtë çështje gjyqësore, konkludon se qëndrojnë pretendimet e saj nën

argumentet se çështja është trajtuar sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, i pandryshuar në vitin 2017, për shkak se çështjet në gjykim e sipër përpara hyrjes së ndryshimeve të Kodit kanë vijuar me dispozitat e mëparshme dhe se për pasojë pretendimet e denoncuesit lidhur me urdhërimin e një afati për caktimin e seancës gjyqësore, kur ky afat është caktuar vetëm me amendimet e reja të legjislacionit procedural, ndërsa padia ishte depozituar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Koditë të Procedurës Civile, mbeten të paargumentuara. Trupi gjykues, në këtë vlerësim procedural, mban në konsideratë edhe lënien në fuqi të vendimmarrjes së subjektit nga një gjykatë më e lartë.

Ndërsa, sa i përket tejkalimit të afatit të arsytimit të vendimit, trupi gjykues merr në konsideratë vetë pranimin e subjektit lidhur me këtë fakt, ngarkesën e punës së këtij të fundit, pra volumin e çështjeve të caktuara për gjykim, kompleksitetin e çështjes për të cilin subjekti ka sqaruar, tejkalimin e afatit vetëm me 4 ditë, faktin që rasti gjyqësor nuk i ngjan rastit dhe se për secilën çështje merr vlerë sigurimi i një procesi të rregullt ligjor për palët, si dhe faktin që pala ka ushtruar të drejtën ankimore, pra indirekt ka tejkaluar pretendimin e vonesës së arsytimit të vendimit.

#### **4. Denoncimi<sup>84</sup> i shtetases F. H.**

**4.1** Denoncuesja ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit se ka shkelur ligjin procedural në vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2019.

Gjithashtu ankohet për zvarritje të procesit deri në vendimmarrjen e dhënë për plotësimin e të metave të padisë. Denoncuesja sqaron se ka bërë me dije gjykatën se adresat janë ato që ka vënë në dispozicion nëpërmjet padisë dhe se në këto kushte kthimi i padisë për këto arsye nuk duhet të kishte ndodhur. Po të njëjtin pretendim parashtron edhe me pikën tjetër të kthimit të padisë, mungesën e tagrit të përfaqësimit, duke pretenduar se ka depozituar prokurën, si dhe ka nënshkruar edhe vetë padinë. Denoncuesja pretendon se gjyqtarja ka vepruar në kundërshtim me nenin 154/1/b të Kodit të Procedurës Civile. Ajo citon se e ka ankimuar vendimin.

Kjo shtetase ka depozituar kërkesëpadinë, vendimin gjyqësor datë 18.9.2019, prokurën e posaçme datë 17.12.2018, si dhe ankimin e veçantë ndaj vendimit datë 18.9.2019.

i) Nga verifikimi i vendimit gjyqësor, në pjesën arsyetuese cilësohet se mungojnë gjeneralitet e plota të paditëses (që në këtë rast është denoncuesja) dhe adresa e banimit me qëllim njoftimin e saj, ndërsa nga verifikimi i padisë vërehet lehtësisht se pasqyrohen gjeneralitetet dhe adresa e secilës prej palëve ndërgjyqëse, që në këtë rast pala e paditur është vajza e paditëses, me banim të cilësuar jashtë vendit.

ii) Sa i përket aktit të përfaqësimit, ai është hartuar i veçantë dhe për pasojë prodhon efekte për aq sa parashikohet në të, ndërsa konstatohet se denoncuesja, me cilësinë e paditëses, ka nënshkruar edhe vetë padinë.

**4.2** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi konstatimin e pasqyruar në pikën (i) të këtij denoncimi.

**4.3** Subjekti, në parashtrimet e saj lidhur me pretendimet e denoncuesit, ka sqaruar se çështja civile e regjistruar në datën 9.9.2019, ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2019, sipas të cilit është vendosur: “*Kthimi i padisë dhe i akteve të tjera palës paditëse F. H., etj.*”. Subjekti ka qartësuar mbi disa aspekte të procedurës së shqyrtimit të padisë në veprime paraprake, të cilat kryhen pa praninë e palëve, jashtë seancës përgatitore, apo lidhur me

---

<sup>84</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019.

domosdoshmërinë e vlerësimit të padisë pa të meta<sup>85</sup>. Për rastin konkret, subjekti ka qartësuar ligjërisht<sup>86</sup> edhe mbi konstatimin e përfaqësimit në kundërshtim me ligjin dhe afatin që i caktohet palëve për të rregulluar aktet e përfaqësimit. Subjekti ka sqaruar lidhur me të metat e konstatuara në pjesën hyrëse të padisë, konkretisht, *mbi mungesën e adresës së vendbanimit apo vendqëndrimin të paditëses (si pjesë e gjeneraliteteve të plota të palës paditëse), krahas asaj të përfaqësuesve, si dhe konsiderimit prej saj të aktit të përfaqësimit, si një akt në të cilin nuk përmbaheshin tagra të qarta përfaqësimi në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor të padisë, pasi nga leximi në tërësi i prokurës është dukshëm i qartë se avokatëve iu janë dhënë tagra të kufizuara vetëm në lidhje me konfliktet e pronësisë së palës paditëse vetëm në lidhje me dy prona të paluajtshme, të cilësuar në mënyrë të shprehur në prokurë*. Subjekti ka qartësuar edhe faktin se denoncuesja, në cilësinë e paditëses edhe në plotësimin e të metave të padisë dhe aktit të përfaqësimit, nuk ka përmbushur të metat e konstatuara nga gjykata. Në lidhje me vendimmarrjen e kthimit të padisë me nr\*\*\*, datë 14.10.2019, përfaqësuesit e saj kanë ushtruar ankim ndaj vendimit dhe çështja është regjistruar në gjykatën e apelit me nr. \*\*\* akti, datë 12.11.2019. Subjekti ka depozituar disa prova, ku ndër të tjera, edhe dy vendimet për kthimin e padisë, fletëhirrje, kopje të kërkesëpadisë, ankimin e veçantë datë 4.11.2019, prokurën e posaçme, si dhe ekstraktin historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e përfaqësuesve ligjorë.

**4.4** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, bazueshmërisë ligjore të cilësuar në secilin prej argumenteve mbi të cilën subjekti është shprehur në kthimin e padisë, çmon se me gjithë kërkimet e gjykatës ndaj palës ndërgjyqëse për të përmbushur të metat e padisë, të cilat i përkasin kryesisht aspektit procedural, çdo argumentim ndryshe do të zëvendësonte logjikën e përdorur në arsyetimin e vendimit. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë çështja është ankimuar, ligjërimi i vendimmarrjes së subjektit është kompetencë e gjykatës më të lartë. Në të tilla kushte nuk evidentohen problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

**Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit**, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

#### **Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

<sup>85</sup> Neni 158 i Kodit të Procedurës Civile parashikon veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm: “1. Gjykata, pasi e vlerëson padinë pa të meta në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të këtij Kodi, i kërkon të paditurit të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesëpadisë...”

<sup>86</sup> Neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile parashikon vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake: “1. Në rast se nga studimi paraprak i akteve, gjyqtari konstaton mungesën e juridiksionit ose kompetencës, ose palëve u mungon zotësia për të vepruar ose përfaqësimi është në kundërshtim me ligjin, atëherë ai duhet përkatësisht të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, dërgimin e çështjes për gjykim gjykatës kompetente, disponon me vendim, sipas parashikimeve të këtij Kodi, ose i cakton afat palëve për të rregulluar aktet e përfaqësimit...”

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani, Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësore (e komanduar).
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.2.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*